

PËR MËSUESIN/EN

3

duk gjini
shtëpia botuese publishing house

Nazlije Cakolli

EDUKATË MUZIKORE

Për klasën e tretë të arsimit fillor

PËRMBAJTJA

Parathënie.....	4
Udhërrëfyes	5
Hyrje.....	7
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 2.....	10
Rezultatet e të nxënit të fushës: Artet - shkalla 2.....	13
Planifikimi vjetor i temave mësimore për fushën e kurrikulës: Artet - Klasa III	15
Plani dymujor: shtator—tetor	16
Plani dymujor: nëntor—dhjetor	19
Plani tremujor: janar—shkurt—mars.....	22
Plani tremujor: prill—maj—qershor	25
Mësimi 1: “Zilja jonë”.....	28
Mësimi 2: Tingulli i gjatë dhe tingulli i shkurtër	30
Mësimi 3: Të rikujtojmë çelësin sol.....	32
Mësimi 4: “Shiu pikëlon”	34
Mësimi 5: “Troket vjeshta”.....	36
Mësimi 6: Këndojmë bukur	38
Mësimi 7: Instrumentet ritmike popullore	40
Mësimi 8: Vlerat e notave.....	42
Mësimi 9: Cakto notat katërshe dhe notat tetëshel.....	44
Mësimi 10: Zemra bën tik-tak	46
Mësimi 11: Skënderbeu në veprat muzikore.....	48
Mësimi 12: Tingulli i lartë dhe tingulli i ulët.....	50
Mësimi 13: Muzika vokale dhe muzika instrumentale.....	52
Mësimi 14: “Hyri vallja në shtëpi”	54
Mësimi 15: Të këndojmë: “Viti i Ri”	56
Mësimi 16: Ksilofoni - “Zilja tring (Jingle Bells)”	58
Mësimi 17: Shprehuni përmes vallëzimit	60
Mësimi 18: Festojmë së bashku.....	62
Mësimi 19: Të këndojmë: “Pse e dua muzikën?”	64
Mësimi 20: Violina - Klarineta	66
Mësimi 21: Ushtrim ritmik me nota katërshe dhe tetëshe	68
Mësimi 22: Të këndojmë: “Urime, Kosovë!”	70
Mësimi 23: Të këndojmë: “Lumenjtë e vendit tim”, “Për mëmëdhenë”	72
Mësimi 24: Plotëso katrorët e zbrazët dhe zbulo!	74
Mësimi 25: Këngët tona popullore.....	76
Mësimi 26: “Karnavali i kafshëve”	78
Mësimi 27: Të këndojmë: “Lulet e Marsit” - Kompozitorë të njohur të muzikës për fëmijë...80	
Mësimi 28: Dinamika.....	82
Mësimi 29: Vlerësim i njohurive	84
Mësimi 30: T’i njohim institucionet kulturore	86
Mësimi 31: Profesionet muzikore: Kompozitori, dirigjenti, interpretuesit.....	88

Mësimi 32: Kompozitorët e vegjël.....	90
Mësimi 33: Të këndojmë: "Xixëllonja"	92
Mësimi 34: Gjëegjëza	94
Mësimi 35: Të ndërtojmë instrumente.....	96
Mësimi 36: Të këndojmë: "Ëndrra dhe dëshira"	98
Mësimi 37: Të këndojmë: "Pesa në librezë"	100
Mësimi 38: Përmbledhje e punës	102

Të dashur mësues dhe mësuese,

Në duar keni librin tuaj, i hartuar për t'ju ardhur në ndihmë për zhvillimin e mësimit, mbështetur në metodologjitë më të përparuara bashkëkohore.

Sistemi arsimor në Kosovë ka kaluar nëpër vështirësi të ndryshme dhe në shkolla janë përdorur metoda tradicionale të mësimit. Sot është mundësia që arsimit t'i pajisë nxënësit me kompetencat që u nevojiten, për ta formësuar jetën e tyre dhe për të kontribuar në shoqëri. Për ta gjetur mënyrën më të mirë dhe për ta realizuar këtë synim, shtëpia botuese "Dukagjini" ka nisur projektin për përfshirjen e metodologjive të mësimit ndërvepruese në librat e mësuesve, i cili ka për qëllim t'ju ndihmojë të gjeni përgjigje për pyetjen themelore: "Çfarë metodologjie do të përdorni për të ndërtuar e krijuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që do t'u nevojiten nxënësve të Kosovës për ta formësuar të ardhmen e tyre?"

Integrimi në hapësirën arsimore të shekullit të 21-të kërkon, midis të tjerash, modernizimin e metodave ekzistuese të mësimit dhe të nxënimit, futjen e veprimtarive bashkëkohore në mësim, që mundësojnë përgatitjen e një individi aktiv, të pavarur dhe të lirë, të pajisur me shprehje të menduarit kritik, krijues, komunikues dhe bashkëpunues, i aftë për t'i përmbushur kërkesat e shoqërisë së sotme.

Cilësia e re e nxënimit dhe mësimit përbën përparësi absolute për arsimin. Ju nuk jeni vetëm burime informacioni, por lypet të përdorni metoda dinamike të mësimit, të quajtura edhe metoda mësimore ndërvepruese, të cilat përbëjnë elementet bazë të këtij modeli, për t'i motivuar nxënësit që të angazhohen më shumë në mësim.

Modeli i këtyre librave po përdoret për herë të parë në Kosovë dhe mësimet janë hartuar nga kolegët tuaj, me profesionalizëm, përkushtim dhe përgjegjësi maksimale.

UDHËRRËFYES për konceptimin e mësimëve model

Faqja në të majtë

- Këto janë të dhëna identifikuese, të cilat orientojnë për mësimin.
- Rezultatet e të nxënët të temës janë në koherencë me ato të fushës.
- Mësimi synon që, përmes rezultateve të të nxënët, të kontribuojë në një ose disa prej kompetencave.
- Rezultatet specifike të të nxënët janë ato mbi të cilat ndërtohet mësimi.
- Janë zërthim i rezultateve të të nxënët sipas niveleve të arritjes. Përcaktohen me nxënësit në klasë.



- Paraqitja e faqes së librit të nxënësit, ndihmon mësuesin/en gjatë përgatitjes.
- Të gjitha mjetet dhe materialet që ndihmojnë në konkretizim.
- Zakonisht mësimi ka lidhje me lëndë dhe fusha të tjera, të cilat evidentohen.
- Metodologjia e mësimit ndërtohet në hapa, të cilët mund të jenë tre ose edhe më shumë. Tri figurat jepen së bashku, çka sugjeron që mësimi duhet të ndërtohet mbi të mëparshmen, për të vijuar më pas me dije e shkathtësi të reja.

Faqja në të djathtë

- Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësuesin/en gjatë përgatitjes.
- Në fund të mësimit bëhet vlerësimi formues i nxënësve për veprimtaritë e zhvilluara në mësim.
- Për t'i përforcuar dijet dhe shkathtësitë, në fund të mësimit jepen detyra për t'u kryer në shtëpi.
- Vetëreflektim dhe vetëvlerësim për orën mësimore në raport me arritjen e rezultateve të nxënësve.



- Pas pjesës hyrëse, vijon hapi tjetër për pjesën kryesore të mësimit ku, përmes përdorimit të teknikave të ndryshme, të nxënët bëhet më tërheqës dhe nxënësit bëhen aktivë, duke u përfshirë në veprimtari të ndryshme.
- Veprimtaritë në këtë hap a këta hapa të mësimit udhëhiqen nga mësuesi/ja dhe nxënësit i kryejnë ato sipas udhëzimeve apo duke ndjekur modelin gjysmë të përgatitur.
- Hapi i fundit është praktikë e pavarur ku nxënësit inkurajohen që t'i vazhdojnë veprimtaritë, por tashmë të pavarur dhe inkurajohen duke u dhënë sugjerime kur është e nevojshme.

Përshkrim i rubrikave kryesore të orës së mësimit

Rezultatet e të nxënët të temës: Janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme, të cilat janë pika referuese në përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore për lëndën dhe rezultateve të të nxënët për këtë temë. Në këtë rast mund të merren nga tabela e krahasimit të planeve dhe programeve ekzistuese me Kurrikulën Bërthamë, por edhe mund të hartohen vetë, mund të jenë një, dy a më shumë rezultate. Një rezultat i të nxënët të lëndës mësimore mund të shërbejë për një apo më shumë njësi mësimore, kjo varet nga përshkrimi i rezultatit të të nxënët dhe nga elementet përbërëse të tij.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht në rezultatet e tyre, bëhet përmes fushës kurrikulare, e cila kontribuon në arritjen e rezultateve të kompetencave. Të gjitha kompetencat kryesore të kurrikulës zërthehen në rezultate të të nxënësve. Ato janë pjesë e Kurrikulës Bërthamë dhe parashihen të përvetësohen nga nxënësit, me rastin e përfundimit të shkallës së kurrikulës.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: Shprehin kërkesat thelbësore të arritjes në fushën kurrikulare, drejt zotërimit të kompetencave kryesore, në përfundim të shkallës. Ato përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë nxënësi në fund të shkallës a nivelit dhe shprehin një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat. Vendosen rezultatet e të nxënësve të fushës kurrikulare, vetëm ato që reflektohen në temën mësimore.

Rezultatet e të nxënësve: Rezultatet specifike të të nxënësve janë ato mbi të cilat ndërtohet ora e mësimin, të cilat përbëjnë detajimin e rezultateve të të nxënësve të temës, të cilat janë në koherencë me ato të fushës së kurrikulës.

Kriteret e vlerësimit/suksesit: Janë zërthim i rezultateve të të nxënësve sipas niveleve të arritjes dhe sigurojnë vlerësim të drejtë për shkallën e zotërimit. Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Metodologjia dhe veprimtaritë me nxënës: Ora mësimore shtrihet në tri faza kryesore: parashikimi (përgatitja për të nxënësve), ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive (përpunimi i përmbajtjes), përfundimi (konsolidimi i të nxënësve).

Çfarë simbolizon modeli me tri pamje të ndryshme të ciklit të jetës së bimës së grurit në tri fazat e mësimin?

Mbillet një farë. Pasi është bërë puna themelore e fillimit, mësuesi vazhdon dhe fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Cikli i jetës së grurit, nga fara në tokë, në bimë, e prapë në farë, sugjeron, gjithashtu, ciklin e vazhdueshëm të shkollimit, përmes mbështetjes në njohuritë ekzistuese, për të vazhduar më tej.



Parashikimi: Përgatitja për të nxënësve

Në fazën e parashikimit mbillet një farë në një truall pjellor. Mësimi duhet të mbështetet edhe në njohuritë ekzistuese të nxënësve, ashtu si fara merr ushqim nga trualli ku është mbjellë.

Kjo është faza e parë e strukturës për zhvillimin e të menduarit dhe të nxënësve, kryhen veprimtari të ndryshme njohëse, nxënësi është i përfshirë gjallërisht në rikujtimin e asaj ç'ka di rreth temës së mësimin, bën lidhjen e njohurive të reja me ato që dihen. Nxënësit ndërtojnë njohuritë, konceptet, kuptimin e ri mbi dukuritë e caktuara nga bazat e njohurive të mëparshme.



Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Mësimi vazhdon me fazën e ndërtimit të njohurive; fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kjo është faza e dytë e strukturës për zhvillimin e të menduarit të nivelit të lartë gjatë të nxënësve dhe nxënësi është i përfshirë në procesin e përfitimit të kuptimit të njohurive, gjithashtu ruan interesin dhe ritmin e vendosur gjatë fazës së parashikimit.



Përfundimi: Konsolidimi i të nxënësve

Mësimi përfundon me fazën e përfundimit. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Në këtë fazë, nxënësit konsolidojnë të nxënësve të ri dhe ristrukturojnë skemën e tyre për t'i përshtatur konceptet e reja dhe për t'i zbatuar ato.

HYRJE

Konceptimi dhe ndërtimi i librit për mësuesin/en

EDUKATË MUZIKORE 3

Kontaktet e para me muzikën fëmija i merr që në moshë të hershme, fillimisht në rrethin familjar e pastaj edhe përmes edukimit muzikor në institucione parashkollore. Ata vazhdimisht këndojnë, dëgjojnë muzikë në rrethin ku jetojnë, dëgjojnë zërat në natyrë, onomatopetë e ndryshme ritmike dhe melodike etj. Këto përvoja të hershme mund të përdoren për edukimin muzikor në shkollimin fillor, duke i konkretizuar këto përjetime nga jeta e përditshme me lojëra, këngë, ligjërime ritmike, lëvizje etj.

Përmes aktivitetit muzikor, te fëmijët sjellim gëzim, hare, relaksim, entuziazëm dhe në këtë mënyrë muzika ndikon direkt në pasurimin emocional të tyre, i fisnikëron ata dhe njëkohësisht ndikojmë në zhvillimin e dispozitave të ndonjë prej aftësive muzikore për të cilën ata mund të kenë predispozitë.

Udhëzime metodologjike

Për zbatim praktik të planifikimit mësimor për artet, brenda orës mësimore dhe jashtë saj në realizimin e aktiviteteve kurrikulare dhe jashtëkurrikulare, nevojitet përdorim i përshtatshëm i metodologjive të mësimdhënies dhe të të nxënës.

Metodologjia ndërvepruese në mësimdhënie dhe të nxënës

Libri që keni në duar është hartuar për t'ju pajisur me metodologjinë ndërvepruese në ndërtimin e dijeve dhe formimin e shkathtësive. Ai trajton temat mësimore në përputhje me “Kurrikulën Bërthamë për Klasën Përgatitore dhe Arsimin Fillor të Kosovës” (2016), si edhe të gjitha dokumentet dhe udhëzimet administrative në fuqi, ku është mbështetur metodologjia me të gjitha elementet përbërëse, duke filluar me kontributin në kompetencat kryesore dhe rezultatet e të nxënës të fushës, rezultatet specifike të të nxënës të njësisë mësimore, mjetet e punës, ecurinë metodologjike të orës së mësimimit e deri te vlerësimi i nxënësve.

Një nga risitë e këtij libri është se përmban edhe një rubrikë: *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore*. Qëllimi i kësaj rubrike është që t'ju ndihmojë të mbani shënime për punën tuaj në klasë, arrijtjet, si dhe rastet kur nuk mund t'i arrini ato, dhe më pas të reflektoni kur të bëni përsëritje, të kontrolloni dijet dhe të bëni vlerësimin e nxënësve, por edhe kur të zhvilloni mësimin një vit apo disa vjet më pas. Suksesi i nxënësve arrihet nga puna dhe angazhimi i mësimdhënësit dhe nxënësit. Kjo arrihet duke përdorur qasje krijuese, ndërvepruese, gjithëpërfshirëse, ekipore, si dhe duke përdorur metoda, teknika e forma të shumëllojshme të punës.


Përmbajtja tematike korrespondon me temat që trajtohen nga fushat e tjera mësimore, por edhe me çështjet e ndryshme ndërkurrikulare. Gjatë këndimit nxënësi aplikon qëndrim të drejtë, këndim me emocion, shqiptim të saktë të tekstit, këndon në intonacion sa më të saktë. Fëmijët inkurajohen të këndojnë vetëm, por edhe në grup, të krijojnë efekte të veçanta tingujsh (imitimin e zërave të shkokëve, të instrumenteve të ndryshme etj.), duke përdorur zërin, shkopinjat, shuplakat ose instrumentet, të ndjekin ndryshimet e ritmit etj.

Puna me instrumentet muzikore shton interesin për aktivitetet muzikore si dhe ndihmon drejt në edukimin e ndjenjës ritmike apo melodike.

Dëgjimi është mënyra kryesore nëpërmjet së cilës fëmija vihet në marrëdhënie me muzikën. Përmes dëgjimit ata shprehin emocione që sjell kënga, vepra instrumentale etj.

Mësuesi duhet të kultivojë ndjenjën e të dëgjuarit të zërit të tij përderisa fëmija këndon këngën, të shoqërojë muzikën me lëvizje të përshtatshme.

Në aspektin e ndërlidhjes dhe të integritimit, muzika mund të jetë pjesë e çdo teme të realizuar nga fusha të ndryshme. P.sh., në matematikë, krahasimi i thyesave me ndarjen e njësisë për numër (nota katërshe, gjysmë, tetëshe); dukuritë e ndryshme muzikore në shkencat e natyrës (si prodhohet zëri, si përçohet zëri etj.); ushtrimet gjatë orëve të edukatës fizike, sportet dhe shëndeti (ecja, vrapi, aktivitetet e ndryshme) mund të shoqërohen me muzikë ritmike. Pra, në çdo temë apo njësi mund të inkuadrohet muzika përmes dëgjimit ose këndimit për të bërë mësimin më interesant për fëmijët e kësaj moshe. Muzika është mjet i mirë për relaksim gjatë pushimeve të shkurtra. Muzika relaksuese dhe e qetë i qetëson nxënësit dhe ndikon që të jenë të përgatitur për mësimin e radhës. Shumë aktivitete rutinë mund të sinjalizohen përmes këngëve të ndryshme ose shembujve adekuatë muzikorë për dëgjim.




Metodologjia e çdo teme zhvillohet në mënyrë pamore rreth mësimin të librit të nxënësit, e cila ju ndihmon ta shikoni atë pa pasur nevojën që ta keni pranë. Përdorimi i kësaj mënyre të paraqitjes së mësimin ka dhënë rezultate mjaft të mira.

Metodologjia ndërvepruese ka si qëllim përfshirjen aktive të nxënësve në ndërtimin e dijes dhe formimin e shprehive. Zhvillimi i nxënësve që mendojnë në mënyrë kritike e që janë krijues është në qendër të metodave të mësimdhënies, të mënyrave të të nxënësit e të çdo veprimtarie tjetër, me synim zhvillimin e shprehive të të menduarit të nivelit të lartë. Por, nga ana tjetër, jemi mbështetur edhe në parimet e psikologjisë së edukimit, kryesisht të zhvillimit njohës sipas moshave, me konsideratë të veçantë Zonën e Zhvillimit Proksimal të Vigotskit, e cila është zona midis nivelit aktual të zhvillimit të fëmijës sipas

Zgjeroni dhe thelloni dijet
Për më shumë lexoni në: Woolfolk, A. (2011) *Psikologji edukimi*. Tiranë: CDE, faqe 47-51.

përcaktimit të aftësive për zgjidhjen e pavarur të problemeve dhe nivelit të zhvillimit që fëmija është në gjendje të arrijë, përmes orientimit të të rriturve apo në bashkëpunim me bashkëmoshatarët e tij më të aftë. Kjo është një hapësirë dinamike ku mësimdhënien mund të japë rezultate e ndodhet diku midis asaj që nxënësi di dhe asaj që nxënësi nuk është gati të mësojë. Zona e Zhvillimit Proksimal është hapësira e mësimin midis së mërztitshmes dhe së pamundurës. Në këtë hapësirë, mbështetja nga

mësuesi apo nga një bashkëmoshatar mund të bëjë që mësimin të japë rezultate.



Burimi: Psikologji edukimi, (faqe 47), A. Woolfolk, 2011. Botuar në Tiranë: CDE

Sipas Piazhësë, fëmijët e klasës së parë dhe të dytë bëjnë pjesë në stadin paraoperacional dhe proceset kryesore të të menduarit tek ata bazohen kryesisht në vëzhgim. Në këtë mënyrë, është e mundur të kultivohen elementet dhe shprehitë e para të të menduarit kritik; por edukimi në mënyrë sistematike i tyre, që bëhet më pas shprehi e rëndësishme e të menduarit të nivelit të lartë, fillon në klasën e tretë. Për këtë arsye, mësimet janë të strukturuar në disa hapa të thjeshtë, të cilët me kujdes dhe në mënyrë të përshkallëzuar japin ndihmesën e tyre në ndërtimin dhe krijimin e dijeve, si dhe formimin e shprehive.



Zgjeroni dhe thelloni dijet

Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011)

Psikologji edukimi. Tiranë: CDE, faqe 32-36.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 2

I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv	
1.	Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë.
2.	Shkruan një tekst deri në një faqe (500 fjalë) e më shumë për një temë të caktuar.
3.	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.
4.	Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërën nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.
5.	Merr pjesë në organizimin e një shfaqjeje artistike në harmoni me moshën e vet, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.
6.	Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo ndonjë ngjarjeje nga jeta, bën dallimin e tyre duke bërë një listë me vetitë që i pëlqejnë dhe që nuk i pëlqejnë tek ata, diskuton rreth tyre, performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarë.
7.	Shpreh, në formë verbale dhe të shkruar, fjali të thjeshta në gjuhë të huaj dhe përkthen në gjuhë amtare fjali të tjera të thjeshta që i dëgjon nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësuesi në gjuhë të huaj, të dhëna si detyrë.
8.	Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët, si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informacioneve të tjera.

II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ	
1.	Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njëres nga format shprehëse.
2.	Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësuesor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera).
3.	Paraqet për diskutim argumentet për pajtueshmërinë ose kundërshtimin për një mendim e qëndrim të shprehur apo sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
4.	Zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkencat e natyrës, shoqëria ose fusha të tjera dhe jep një shembull e më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë mund të përdoret në situata të ngjashme.
5.	Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës, duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.
6.	Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, historiko-shoqërore) në njërën nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie.
7.	Paraqet dhe arsyeton me argumente mënyrën e zgjidhjes së një problemi/detyrë të caktuar të fushave të ndryshme (matematikore, gjuhësore, të shkencave të natyrës, shoqërore, të arteve, shëndetësore... etj.) në kohëzgjatje prej 6-10 minutash.
8.	Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërrimeve apo pozitive në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimet) të tyre.

III. Kompetenca e të nxënës – Nxënës i suksesshëm	
1.	Parashtron pyetje që nxësin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërës nga format e shprehjes.
2.	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.
3.	Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuara, duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shenjuar me shenja të ndryshme).
4.	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.
5.	Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një aktiviteti të caktuar.
6.	Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara dhe bën një plan për mënyrën e korrigjimeve të nevojshme.
7.	Identifikon cilësitë e veta që i posedon dhe cilësitë e nevojshme që duhet t'i zhvillojë për të nxënë një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët.
8.	Menaxhon sjelljet e veta, materialet/mjetet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti individual apo të përbashkët në klasë/shkollë apo jashtë saj.
9.	Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinën për zgjidhjen e një problemi/detyre të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv	
1.	Përgatit një autobiografi në të cilën prezanton veten me të dhënat personale dhe me prirjet për fusha të caktuara, duke i gjetur të përbashkëtat me profesionet e dëshiruara.
2.	Përgatit një plan pune për një javë dhe specifikon aktivitetet më me prioritet duke arsyetuar përzgjedhjen e tyre.
3.	Përgatit një projekt të vogël duke veçuar aktivitetet kryesore për çështje që e preokupojnë atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për kryerjen e tyre etj.
4.	Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes.
5.	Debaton me moshatarë për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë/laborator, në shkollë dhe në mjedise të tjera apo për një grup të caktuar njerëzish për një situatë të caktuar, duke mbrojtur idetë e veta me shembuj konkretë.
6.	Identifikon ushqimet më të shpeshta, materialet e tjera shpenzuese të familjes apo harxhimet vetjake dhe llogarit shpenzimet për një javë; të dhënat e gjetura i paraqet në formë tabelare/grafike apo në një formë tjetër.
7.	Lexon etiketën, udhëzuesin e produkteve të ndryshme (rrobave, ushqimit, barnave apo të teknikës) dhe jep sqarim për prejardhjen, përmbajtjen, përdorimin, mënyrën e mirëmbajtjes apo për rreziqet në rast mospërdorimi të drejtë (adekuat).
8.	Paraqet në formë tabelare, grafike, të vizatimit apo në një formë tjetër, aktivitetet e kujdesit që i bën ndonjë qenieje të gjallë, të cilat i mundësojnë zhvillimin, rritjen apo ruajtjen e shëndetit të saj.

V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

1.	Prezanton para të tjerëve mënyrën e zbatimit të rregullave themelore të higjienës personale (fizike, të veshmbathjes, të gjësedeve personale) dhe të higjienës së mjedisit, ku jeton dhe vepron, përmes formave të ndryshme të shprehjes.
2.	Merr pjesë në aktivitete fizike/lojëra lëvizore dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer, menaxhon emocionet e veta dhe prezanton para të tjerëve gjendjen fizike dhe shpirtërore pas realizimit të një aktiviteti fizik apo loje sportive.
3.	Përgatit një listë (me njërin nga format e shprehjes: shkrim, vizatim etj.) me ushqime të cilat i konsumon familja, duke i renditur ato sipas kalorisë dhe më pas i klasifikon në ushqime të shëndetshme dhe më pak të shëndetshme.
4.	Lexon të dhënat në paketim të ushqimit dhe diskuton në grup për këto të dhëna (vlerat ushqyese, afatet e prodhimit etj.).
5.	Identifikon përparësitë dhe mangësitë e personalitetit të vet dhe jep mendime për mënyrën e përmirësimit, në forma të ndryshme shprehëse.
6.	Propozon alternativa për zgjidhjen konstruktive të një konflikti ndërpersonal duke i analizuar paraprakisht me kujdes rrethanat që kanë shkaktuar konfliktin, ndan përvojat, mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit.
7.	Dallon dhe përshkruan rolet e personave dhe shërbimeve të nevojshme për kërkimin e ndihmës në situata të caktuara të rrezikut të shëndetit të vet, fizik dhe mendor.
8.	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkollë apo jashtë saj).
9.	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes dhe pjesëmarrësve të tjerë kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

1.	Paraqet në forma të ndryshme të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të familjes së vet dhe i diskuton ato me të tjerët, më pas i krahason me të drejtat dhe përgjegjësitë e nxënësve, mësuesve dhe stafit menaxhues në shkollë apo me pjesëtarët e ndonjë institucioni.
2.	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.
3.	Propozon vlera shoqërore, që janë të rëndësishme të kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si p.sh. besimi i ndërsjellë, toleranca, solidariteti, respekti, mirësjellja etj.) dhe me shembull konkret përshkruan ndonjë situatë ku gjen shprehje ndonjëra nga ato.
4.	Manifeston veprime që shprehin mirësjellje në situata të ndryshme dhe me shembull konkret tregon përdorimin e tyre në klasë/shkollë, në familje e në komunitet.
5.	Propozon dhe ndan mendimin me shokët/shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve të aktiviteteve të ndryshme me karakter mësues, të këshillave në klasë apo në shkollë, përbërjen dhe rolin e tyre.
6.	Merr pjesë në hartimin e rregullave të lojës, në klasë, në shkollë (p.sh., si propozues rregullash, menaxhues i propozimeve nga të tjerët etj.) dhe argumenton rëndësinë e respektimit të ndonjërit rregull të propozuar në forma të ndryshme të shprehjes, duke parashikuar pasojat e moszbatimit të saj.
7.	Identifikon dy e më shumë organizime shoqërore dhe përshkruan (në formë të shkruar apo në ndonjë formë tjetër) mënyrat/mundësitë se si njerëzit e ndryshëm me përvoja të ndryshme mund të organizojnë diçka të përbashkët.
8.	Prezanton në mënyrë kronologjike ndryshimet e familjes dhe të rrethit në aspekte të ndryshme (si: objektet e banimit, festat, veshjet, ushqimet - mënyra e të ushqyerit, menaxhimi i ekonomisë familjare, të drejtat, përgjegjësitë dhe vendimmarrja në familje etj.) ose disa nga personalitetet dhe ngjarjet kryesore të popullit të vet, duke e dalluar të tashmen nga e kaluara.
9.	Paraqet me shembuj konkretë sjelljet që duhen manifestuar në rast rreziku nga fatkeqësitë natyrore apo të krijuara nga njeriu, si: zjarri, vërshimi, tërmeti, komunikimi me njerëz të panjohur etj.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS ARTET - Shkalla 2

I. NJOHURITË, TË KUPTUARIT DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen	
<p>1. Krijimtaria dhe performanca artistike</p> <p>Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.</p> <p>Nxënësi/ja zhvillon shkathtësitë performuese (interpretuese) në një apo në më shumë vepër artistike:</p>	
1.	Këndon individualisht dhe në grup, këngë e melodi sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole (lule, flutura, katrorë etj.).
2.	Ritmizon vargje, ritme me zë dhe me vegla muzikore sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole.
3.	Krijon forma të ndryshme dy dhe tridimensionale, duke përdorur teknika të ndryshme figurative dhe aplikative.
4.	Luan në instrumente muzikore fëmijërore (të Orfit dhe popullore) sipas prirjes dhe mundësive interpretuese (muzikë).
5.	Lëviz dhe vallëzon sipas muzikës së dëgjuar, tekstit dramatik ose mesazhit artistik që dëshirojnë të shprehin.
6.	Krijon ritme e melodi me zë ose instrumente muzikore në bazë të ritmit ose tekstit poetik.
7.	Krijon lëvizje origjinale kreative sipas muzikës, tekstit letrar ose situatës së caktuar (vallëzim, dramë).
8.	Krijon elemente origjinale në interpretimin e rolit të caktuar dhe paraqitjes skenike.
2. Gjuha dhe komunikimi artistik	
<p>Nxënësit njohin dhe përdorin elementet dhe parimet e gjuhës artistike, proceset dhe teknikat themelore të krijimtarisë artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe në vallëzim.</p> <p>Nxënësi/ja:</p>	
1.	Identifikon dhe përdor në mënyrë origjinale dhe kreative elementet artistike për komunikim artistik të ideve e mesazheve të tyre, p.sh. njeh dhe përdor mënyra të ndryshme të trajtimit të elementeve shprehëse (ritmin, melodinë, harmoninë, formën, dinamikën, tempin, karakterin shprehës, vijat, ngjyrat, formën, lëvizjet, gjestet, emocionet etj.) për të komunikuar idetë personale, mesazhet, emocionet etj.
3. Relacioni art-shoqëri	
<p>Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjellas, në kontekstin historik, social dhe kulturor.</p> <p>Nxënësi/ja:</p>	
1.	Rinjuh vepra artistike ndaj të cilave është ekspozuar gjatë mësimit (rinjuh këngën, veprën muzikore, pikturën etj.).
2.	Emërton dhe dallon gjinitë dhe zhanret e ndryshme artistike.
3.	Prezanton funksionin e disa institucioneve të ndryshme artistike.
4.	Dallon, krahason dhe prezanton krijues, performues dhe formacione interpretuese të zhanreve dhe stileve të ndryshme artistike në nivel kombëtar dhe global.

4. Çmuarja dhe vlerësimi estetiko-artistik

Nxënësit aplikojnë gjykim dhe vlerësim kritik të veprave artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe vallëzim, duke u bazuar në të kuptuarit e filozofisë së artit dhe parimet estetike.

Nxënësi/ja:

1. Çmon dhe vlerëson krijimet dhe performancat artistike (vetanake dhe të tjerëve), duke përdorur terminologji adekuate dhe konceptet e fushës.
2. Komenton veprat artistike dhe shquan elementet karakteristike shprehëse të përdorura, p.sh. ky vizatim është i mirë, ose forma e pemës nuk është mirë, për shkak se...ai/ajo këndoi mirë në ritëm, por melodia nuk ishte e saktë etj. Mua nuk më pëlqen që ke përdorur me tepri ngjyrën x, sepse... pra me gjykim kritik për aq sa lejon moshën dhe aftësia e tyre përjetuese e veprave.

II. QËNDRIMET DHE VLERAT që zhvillohen

Qëndrimi pozitiv ndaj artit dhe së bukurës në natyrë dhe në art

Nxënësi/ja:

- Qëndrimi pozitiv ndaj trashëgimisë kulturore kombëtare;
- Dëshira për shprehje dhe komunikim në mënyrë të pavarur;
- Qëndrimi pozitiv dhe respekti ndaj kulturave të ndryshme;
- Bashkëpunimi dhe përgjegjësia;
- Përqendrimi dhe durimi.

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen

Nxënësi/ja:

- Të vërejturit/të dëgjuarit/aftësitë perceptuese (aftësia për të vërejtur dhe për të dalluar ritmin dhe harmoninë (tingullore, të ngjyrave, të formave, të strukturave, të karaktereve, të lëvizjeve etj.);
- Aftësitë përjetuese artistike;
- Vëmendja dhe memorizimi;
- Vullneti dhe motivacioni;
- Imagjinata dhe krijimtaria;
- Iniciativa dhe interesimi;
- Shkathtësitë muzikore;
- Shkathtësitë lëvizore;
- Shkathtësitë shprehëse figurative;
- Komunikimi dhe të shprehurit artistik multidisiplinar;
- Shkathtësia për punë ekipore;
- Të menduarit analitik, kritik dhe krijues.

Planifikimi vjetor i temave mësimore për fushën e kurrikulës: Artet - Klasa III

Lëndët e fushës kurrikulare	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Rezultatet e kompetencave (Rezultatet e të nxënit për shkallë)
	GJYSMËVJETORI I PARË		GJYSMËVJETORI I DYTË		
	shtator—tetor	nëntor—dhjetor	janar—shkurt—mars	prill—maj—qershor	
Edukatë muzikore	<p>Këngët</p> <p>Instrumentet muzikore</p> <p>Krijuesit dhe performuesit</p> <p>Elementet bazike të gjuhës artistike</p>	<p>Këngët</p> <p>Elementet bazike të gjuhës artistike</p> <p>Instrumentet muzikore</p> <p>Lojërat muzikore</p> <p>Krijuesit dhe performuesit</p>	<p>Këngët</p> <p>Elementet bazike të gjuhës artistike</p> <p>Llojet e muzikës</p> <p>Elementet bazike të gjuhës artistike</p> <p>Instrumentet muzikore</p>	<p>Këngët</p> <p>Elementet bazike të gjuhës artistike</p> <p>Krijimet muzikore</p> <p>Krijuesit dhe performuesit</p> <p>Veprat artistike</p> <p>Ngjarjet artistike</p>	<p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv I. 3, 4, 5.</p> <p>Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ II. 1, 4, 5.</p> <p>Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm III. 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.</p> <p>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë V. 8.</p> <p>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm VI. 2, 3.</p>

PLANI DYMUJOR: SHTATOR—TETOR

Lënda mësimore: Edukatë muzikore

Fusha e kurrikulës: Artet

Klasa: III

Temat mësimore: Këngët, Elementet bazike të gjuhës artistike, Instrumentet muzikore, Krijuesit dhe performuesit

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv*

I.3 Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.1 Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njëres nga format shprehëse.

II.5 Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës, duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.

Kompetenca e të nxënësve – Nxënës i suksesshëm

III.3 Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar, duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shenjuar me shenja të ndryshme).

III.4 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.8 Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.2 Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.

VI.3 Propozon vlera shoqërore, që janë të rëndësishme të kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si p.sh., besimi i ndërsjellë, toleranca, solidariteti, respekti-mirësjellja etj.) dhe me shembull konkret përshkruan ndonjë situatë ku gjen shprehje ndonjëra nga to.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.1	Këndon individualisht dhe në grup, këngë e melodi sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole (lule, flutura, katrorë etj.).
1.2	Identifikon dhe përdor në mënyrë origjinale dhe kreative elementet artistike për komunikim artistik të ideve e mesazheve të tyre, p.sh., njih dhe përdor mënyra të ndryshme të trajtimit të elementeve shprehëse (ritmin, melodinë, harmoninë, formën, dinamikën, tempin, karakterin shprehës, vijat, ngjyrat, formën, lëvizjet, gjestet, emocionin etj.) për të komunikuar idetë personale, mesazhet, emocionet etj.
1.4	Emërton dhe dallon gjinitë dhe zhanret e ndryshme artistike.
1.5	Dallon, krahason dhe prezanton krijues, performues dhe formacione interpretuese të zhanreve dhe stileve të ndryshme artistike në nivel kombëtar dhe global.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e Vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
Këngët	- Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme, të përshatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.).	1. “Zilja jonë” 2. Tingulli i gjatë dhe tingulli i shkurtër 3. Të rikujtojmë çelësin sol 4. “Shiu pikëlon,” 5. “Troket vjeshita” - 6. Këndojmë bukur - 7. Instrumentet ritmike popullore 8. Vlerat e notave	Nr. i orëve 8	- Vlerësim formativ; - Vlerësim përmbledhës.	Gjuhë shqipe; Matematikë; Edukatë figurative; Njeriu dhe natyra; Shoqëria dhe mjedisi; Shkathësi për jetë; Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti. Çështjet ndërkurrikulare: Të drejtat e fëmijëve; Çështjet e barazisë gjinore; Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.	Edukatë muzikore 3
Instrumentet muzikore	- Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësuesit/es dhe në mënyrë kreative.					
Krijuesit dhe performuesit	- Njih notacionin grafik për disa nga vetitë themelore të tingullit muzikor, (lartësitë dhe gjatësitë tingullore). - Përjeton dhe dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur-mol) në këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë. - Dallon disa dukuri muzikore ritmike e melodike në këngët e kënduara dhe në veprat e dëguara. - Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizualisht. - Identifikon ndonjë figurë markante nga krijuesit dhe performuesit artistikë botërorë dhe vendorë.					

PLANI DYMUJOR: NËNTOR—DHJETOR

Lënda mësimore: Edukatë muzikore

Fusha e kurrikulës: Artet

Klasa: III

Temat mësimore: Këngët, Elementet bazike të gjuhës artistike, Instrumentet muzikore, Krijuesit dhe performuesit, Lojërat muzikore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv*

I.3 Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.5 Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës, duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

III.3 Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar, duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shenjuar me shenja të ndryshme);

III.4 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.

III.6 Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara dhe bën një plan për mënyrën e korigjimeve të nevojshme.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.8 Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.2 Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.

VI.3 Propozon vlera shoqërore, që janë të rëndësishme të kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si p.sh., besimi i ndërsjellë, toleranca, solidariteti, respekti-mirësjellja etj.) dhe me shembull konkret përshkruan ndonjë situatë ku gjen shprehje ndonjëra nga to.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

2.1 Identifikon dhe përdor në mënyrë origjinale dhe kreative elementet artistike për komunikim artistik të ideve e mesazheve të tyre, p.sh., njeh dhe përdor mënyra të ndryshme të trajtimit të elementeve shprehëse (ritmin, melodinë, harmoninë, formën, dinamikën, tempin, karakterin shprehës, vijat, ngjyrat, formën, lëvizjet, gjetet, emocionin etj.) për të komunikuar idetë personale, mesazhet, emocionet etj.

3.1 Rinjeh vepra artistike ndaj të cilave është ekspozuar gjatë mësimin (rinjeh këngën, veprën muzikore, pikturën etj.).

3.2 Emërton dhe dallon gjinitë dhe zhanret e ndryshme artistike.

1.5 Dallon, krahason dhe prezanton krijues, performues dhe formacione interpretuese të zhanreve dhe stileve të ndryshme artistike në nivel kombëtar dhe global.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për tema mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e vlerësimit	Metodologjia e vlerësimit	Nërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
Këngët	- Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.).	9. Cakto notat katërshe dhe tetëshe! 10. Zemra bën tik-tak 11. Skënderbeu në veprat muzikore 12. Tingulli i lartë dhe tingulli i ulët 13. Muzika vokale dhe muzika instrumentale 14. “Hyri vallja në shtëpi” 15. “Viti i Ri” 16. Ksilofoni - “Zilja tring” - Jingle bells	Nr. i orëve 8	- Mësimdhënia dhe të nxënësit me fëmijët në qendër dhe gjithëpërfshirja. - Mësimdhënia dhe të nxënësit bazuar në rritjen e kompetencave.	Gjuhë shqipe; Matematikë; Edukatë figurative; Njeriu dhe natyra; Shoqëria dhe mjedisi; Shkathësi për jetë; Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti. Çështjet ndërkurrikulare; Edukimi për paqe.	Edukatë muzikore 3; CD.	
Instrumentet muzikore	- Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësuesit/es dhe në mënyrë kreative.						
Krijuesit dhe performerët	- Njeh notacionin grafik për disa nga vetitë themelore të tingullit muzikor, (lartësitë dhe gjatësitë tingullore).						
Lojërat muzikore	- Përfjeton dhe dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur-mol) në këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë. - Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizualisht. - Dallon ngjyrën tingullore të instrumenteve muzikore (popullore dhe klasike) përmes dëgjimit të veprave						

	<ul style="list-style-type: none"> - muzikore të përshatshme për moshën e tyre. - Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizualisht. - Identifikon ndonjë figurë markante nga krijuesit dhe performuesit artistikë botërorë dhe vendorë. - Luan lojëra të thjeshta muzikore të shoqëruara me këngë, të cilat kanë gjuhë shprehëse të përshatshme me fjalorin e moshës së tyre, të përcjella me lëvizje trupore e me vegla muzikore femijërore dhe që trajtojnë tema të ndryshme, por edhe elemente didaktike të gjuhës artistike muzikore (ritmi, melodia, vetitë e tingullit muzikor etj.). 					
--	---	--	--	--	--	--

PLANI TREMUJOR: JANAR—SHKURT—MARS

Lënda mësimore: Edukatë muzikore

Fusha e kurrikulës: Artet

Klasa: III

Temat mësimore: Elementet bazike të gjuhës artistike,
Këngët, Instrumentet muzikore,
Llojet e muzikës

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv*

I.3 Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.5 Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës, duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

III.4 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.

III.6 Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara dhe bën një plan për mënyrën e korigjimeve të nevojshme.

III.7 Identifikon cilësitë e veta që i posedon dhe cilësitë e nevojshme që duhet t'i zhvillojë për të nxënë një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët.

III.9 Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinë për zgjidhjen e një problemi/detyrë të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

V.8 Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

VI.2 Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendosin për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.

VI.3 Propozon vlera shoqërore, që janë të rëndësishme të kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si p.sh., besimi i ndërsjellë, toleranca, solidariteti, respekti-mirësjellja etj.) dhe me shembull konkret përshkruan ndonjë situatë ku gjen shprehje ndonjëra nga to.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.1	Këndon individualisht dhe në grup, këngë e melodi sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole (lule, futura, katrorë etj.).
1.2	Ritmizon vargje, ritme me zë dhe me vegla muzikore sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole.
1.5	Lëviz dhe vallëzon sipas muzikës së dëgjuar, tekstit dramatik ose mesazhit artistik që dëshirojnë të shprehin.
2.1	Identifikon dhe përdor në mënyrë origjinale dhe kreative elementet artistike për komunikim artistik të ideve e mesazheve të tyre, p.sh., njih dhe përdor mënyra të ndryshme të trajtimit të elementeve shprehëse (ritmin, melodinë, harmoninë, formën, dinamikën, tempin, karakterin shprehës, vijat, ngjyrat, formën, lëvizjet, gjestet, emocionin etj.) për të komunikuar idetë personale, mesazhet, emocionet etj.
3.1	Njeh vepra artistike ndaj të cilave është ekspozuar gjatë mësimin (rinjeh këngën, veprën muzikore, pikturën etj.). Vëren dhe identifikon llojet e institucioneve artistike (galeri, teatër, muze, sallë koncertale etj.).
3.2	Emërton dhe dallon gjinitë dhe zhanret e ndryshme artistike.
3.3	Prezanton funksionin e disa institucioneve të ndryshme artistike.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
<p>Këngët</p> <p>Instrumentet muzikore</p> <p>Elementet bazike të gjuhës artistike</p> <p>Llojet e muzikës</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.). - Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë sipas instruksioneve të mësuesit/es dhe në mënyrë kreative. - Dallon ngjyrën tingullore të instrumenteve muzikore (popullore dhe klasike) përmes dëgjimit të veprave muzikore të përshtatshme për moshën e tyre. - Njeh notacionin grafik për disa nga vetitë themelore të tingullit muzikor. - Dallon lloje të ndryshme të muzikës në shoqëri përmes dëgjimit muzikor. 	<ol style="list-style-type: none"> Shprehimi përmes vallëzimit Festojmë së bashku “Pse e dua muzikën?” Violina - Klarineta Ushtrim ritmik me nota katërshe dhe tetëshe Të këndojmë: “Urime, Kosovë!” Të këndojmë: “Lumenjtë e vendit tim,” “Për mëmëdhenë” Plotëso katrorët e zbrazët dhe zbulo! Këngët tona popullore “Karnavali i kafshëve” Të këndojmë: “Lulet e Marsit” - kompozitorët për fëmijë 	<ul style="list-style-type: none"> - Nr. i orëve 11 - Mësimdhënia dhe të nxënëtit me fëmijët në qendër dhe gjithëpërfshirja. - Mësimdhënia dhe të nxënëtit e bazuar në ritjen e kompetencave. - Mësimdhënia dhe të nxënëtit e integruar. - Mësimdhënia dhe të nxënëtit e diferencuar. 	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësim formativ. 	<p>Gjuhë shqipe; Matematikë; Edukatë figurative; Njeriu dhe natyra; Shoqëria dhe mjedisi; Shkathësi për jetë; Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti. Çështjet ndërkurrikulare: Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.</p>	<p>Edukatë muzikore 3; CD. https://www.youtube.com/watch?v=LDUK-cv2wEy0</p>

PLANI TREMUJOR: PRILL—MAJ—QERSHOR

Lënda mësimore: Edukatë muzikore

Fusha e kurrikulës: Artet

Klasa: III

Temat mësimore: Këngët, Elementet bazike të gjuhës artistike, Krijimet muzikore, Krijuesit dhe performuesit, Veprat artistike, Ngjarjet artistike

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv*

I.3	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.
I.4	Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta, që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërën nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.
I.5	Merr pjesë në organizimin e një shfaqjeje artistike në harmoni me moshën e vet, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.1	Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njëres nga format shprehëse.
II.4	Zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkenca e natyrës, shoqëria ose fusha të tjera dhe jep një shembull e më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë mund të përdoret në situata të ngjashme.
II.5	Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës, duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

III.3	Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shenjuar me shenja të ndryshme).
III.4	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.
III.5	Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një aktiviteti të caktuar.
III.6	Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara dhe bën një plan për mënyrën e korrigjimeve të nevojshme.
III.7	Identifikon cilësitë e veta që i posedon dhe cilësitë e nevojshme që duhet t'i zhvillojë për të nxënë një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët.
III.8	Menaxhon sjelljet e veta, materialet/mjetet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti individual apo të përbashkët në klasë/shkollë apo jashtë saj.
III.9	Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinën për zgjidhjen e një problemi/detyre të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.8	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).
-----	---

Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

VI.2	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.
------	--

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.1	Këndon individualisht dhe në grup, këngë e melodi sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole (lule, futura, katrorë etj.).
1.2	Ritmizon vargje, ritme me zë dhe me vegla muzikore sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole.
2.1	Identifikon dhe përdor në mënyrë origjinale dhe kreative elementet artistike për komunikim artistik të ideve e mesazheve të tyre, p.sh., njeh dhe përdor mënyra të ndryshme të trajtimit të elementeve shprehëse (ritmin, melodinë, harmoninë, formën, dinamikën, tempin, karakterin shprehës, vijat, ngjyrat, formën, lëvizjet, gjestet, emocionin etj.) për të komunikuar idetë personale, mesazhet, emocionet etj.
3.3	Prezanton funksionin e disa institucioneve të ndryshme artistike.
3.4	Dallon, krahason dhe prezanton krijues përformues dhe formacione interpretuese të zhanreve dhe stileve të ndryshme artistike në nivel kombëtar dhe global.
4.1	Çmon dhe vlerëson krijimet dhe performancat artistike (vetanake dhe të tjerëve), duke përdorur terminologji adekuate dhe konceptet e fushës.
4.2	Komenton veprat artistike dhe shquan elementet karakteristike shprehëse të përdorura p.sh., ky vizatim është i mirë, ose forma e pemës nuk është mirë, për shkak se...ai/ajo këndoi mirë me ritëm, por melodia nuk ishte e saktë etj. Mua nuk më pëlqen që ke përdorur me tepri ngjyrën x, sepse... pra me gjykim kritik për aq sa lejon moshën dhe aftësia e tyre përjetuese e veprave.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidh-ja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurr-ikulare	Burimet
Këngët	- Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimit instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirën, lodrat, stinët, festat etj.).	28. Dinamika 29. Vlerësim i njohurive 30. T'i njohim institucionet kulturore 31. Profesionet: Kompozitori, dirigjenti, interpretuesit 32. Krijojmë dhe interpretojmë: Kompozitorët e vegjël 33. Të këndojmë: "Xixëllonja" 34. Gjëgjëza 35. Të ndërtojmë instrumente 36. Të këndojmë: "Ëndrra dhe dëshira" 37. Të këndojmë: "Pesat në librezë" 38. Përmbledhje e punës	Nr. i orëve 11	Mësimdhënia dhe të nxënëti me fëmijët në qendër dhe gjithëpërfshirja. Mësimdhënia dhe të nxënëti e bazuar në rritjen e kompetencave. Mësimdhënia dhe të nxënëti e integruar. Mësimdhënia dhe të nxënëti e diferencuar.	Gjuhë shqipe; Matematikë Edukatë figurative; Njeriu dhe natyra; Shoqëria dhe mjedisi; Shkathësi për jetë; Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti. Çështjet ndërkurrikulare: Të drejtat e fëmijëve; Çështjet e barazisë gjinore.	Edukatë muzikore 3; CD https://www.youtube.com/watch?v=BF-hoHL0nGhk https://www.youtube.com/watch?v=X-4QaKvZqzX4 https://www.youtube.com/watch?v=yrCE-qdMfbno
Elementet bazike të gjuhës artistike	- Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimit instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirën, lodrat, stinët, festat etj.).	28. Dinamika 29. Vlerësim i njohurive 30. T'i njohim institucionet kulturore 31. Profesionet: Kompozitori, dirigjenti, interpretuesit 32. Krijojmë dhe interpretojmë: Kompozitorët e vegjël 33. Të këndojmë: "Xixëllonja" 34. Gjëgjëza 35. Të ndërtojmë instrumente 36. Të këndojmë: "Ëndrra dhe dëshira" 37. Të këndojmë: "Pesat në librezë" 38. Përmbledhje e punës	Nr. i orëve 11	Mësimdhënia dhe të nxënëti me fëmijët në qendër dhe gjithëpërfshirja. Mësimdhënia dhe të nxënëti e bazuar në rritjen e kompetencave. Mësimdhënia dhe të nxënëti e integruar. Mësimdhënia dhe të nxënëti e diferencuar.	Gjuhë shqipe; Matematikë Edukatë figurative; Njeriu dhe natyra; Shoqëria dhe mjedisi; Shkathësi për jetë; Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti. Çështjet ndërkurrikulare: Të drejtat e fëmijëve; Çështjet e barazisë gjinore.	Edukatë muzikore 3; CD https://www.youtube.com/watch?v=BF-hoHL0nGhk https://www.youtube.com/watch?v=X-4QaKvZqzX4 https://www.youtube.com/watch?v=yrCE-qdMfbno
Krijimet muzikore	- Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë sipas instruksioneve të mësuesit/es dhe në mënyrë kreative.	28. Dinamika 29. Vlerësim i njohurive 30. T'i njohim institucionet kulturore 31. Profesionet: Kompozitori, dirigjenti, interpretuesit 32. Krijojmë dhe interpretojmë: Kompozitorët e vegjël 33. Të këndojmë: "Xixëllonja" 34. Gjëgjëza 35. Të ndërtojmë instrumente 36. Të këndojmë: "Ëndrra dhe dëshira" 37. Të këndojmë: "Pesat në librezë" 38. Përmbledhje e punës	Nr. i orëve 11	Mësimdhënia dhe të nxënëti me fëmijët në qendër dhe gjithëpërfshirja. Mësimdhënia dhe të nxënëti e bazuar në rritjen e kompetencave. Mësimdhënia dhe të nxënëti e integruar. Mësimdhënia dhe të nxënëti e diferencuar.	Gjuhë shqipe; Matematikë Edukatë figurative; Njeriu dhe natyra; Shoqëria dhe mjedisi; Shkathësi për jetë; Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti. Çështjet ndërkurrikulare: Të drejtat e fëmijëve; Çështjet e barazisë gjinore.	Edukatë muzikore 3; CD https://www.youtube.com/watch?v=BF-hoHL0nGhk https://www.youtube.com/watch?v=X-4QaKvZqzX4 https://www.youtube.com/watch?v=yrCE-qdMfbno
Krijuesit dhe performuesit	- Njeh notacionin grafik për disa nga vetitë themelore të tingullit muzikor, (lartësitë dhe gjatësitë tingullore).	28. Dinamika 29. Vlerësim i njohurive 30. T'i njohim institucionet kulturore 31. Profesionet: Kompozitori, dirigjenti, interpretuesit 32. Krijojmë dhe interpretojmë: Kompozitorët e vegjël 33. Të këndojmë: "Xixëllonja" 34. Gjëgjëza 35. Të ndërtojmë instrumente 36. Të këndojmë: "Ëndrra dhe dëshira" 37. Të këndojmë: "Pesat në librezë" 38. Përmbledhje e punës	Nr. i orëve 11	Mësimdhënia dhe të nxënëti me fëmijët në qendër dhe gjithëpërfshirja. Mësimdhënia dhe të nxënëti e bazuar në rritjen e kompetencave. Mësimdhënia dhe të nxënëti e integruar. Mësimdhënia dhe të nxënëti e diferencuar.	Gjuhë shqipe; Matematikë Edukatë figurative; Njeriu dhe natyra; Shoqëria dhe mjedisi; Shkathësi për jetë; Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti. Çështjet ndërkurrikulare: Të drejtat e fëmijëve; Çështjet e barazisë gjinore.	Edukatë muzikore 3; CD https://www.youtube.com/watch?v=BF-hoHL0nGhk https://www.youtube.com/watch?v=X-4QaKvZqzX4 https://www.youtube.com/watch?v=yrCE-qdMfbno
Veprat artistike	- Identifikon llojet e institucioneve artistike (galeri, teatër, muze, sallë koncertale etj.).	28. Dinamika 29. Vlerësim i njohurive 30. T'i njohim institucionet kulturore 31. Profesionet: Kompozitori, dirigjenti, interpretuesit 32. Krijojmë dhe interpretojmë: Kompozitorët e vegjël 33. Të këndojmë: "Xixëllonja" 34. Gjëgjëza 35. Të ndërtojmë instrumente 36. Të këndojmë: "Ëndrra dhe dëshira" 37. Të këndojmë: "Pesat në librezë" 38. Përmbledhje e punës	Nr. i orëve 11	Mësimdhënia dhe të nxënëti me fëmijët në qendër dhe gjithëpërfshirja. Mësimdhënia dhe të nxënëti e bazuar në rritjen e kompetencave. Mësimdhënia dhe të nxënëti e integruar. Mësimdhënia dhe të nxënëti e diferencuar.	Gjuhë shqipe; Matematikë Edukatë figurative; Njeriu dhe natyra; Shoqëria dhe mjedisi; Shkathësi për jetë; Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti. Çështjet ndërkurrikulare: Të drejtat e fëmijëve; Çështjet e barazisë gjinore.	Edukatë muzikore 3; CD https://www.youtube.com/watch?v=BF-hoHL0nGhk https://www.youtube.com/watch?v=X-4QaKvZqzX4 https://www.youtube.com/watch?v=yrCE-qdMfbno
Ngjarjet artistike	- Ritmizon në mënyrë kreative vargjet, poezitë, gjëgjëzat etj.	28. Dinamika 29. Vlerësim i njohurive 30. T'i njohim institucionet kulturore 31. Profesionet: Kompozitori, dirigjenti, interpretuesit 32. Krijojmë dhe interpretojmë: Kompozitorët e vegjël 33. Të këndojmë: "Xixëllonja" 34. Gjëgjëza 35. Të ndërtojmë instrumente 36. Të këndojmë: "Ëndrra dhe dëshira" 37. Të këndojmë: "Pesat në librezë" 38. Përmbledhje e punës	Nr. i orëve 11	Mësimdhënia dhe të nxënëti me fëmijët në qendër dhe gjithëpërfshirja. Mësimdhënia dhe të nxënëti e bazuar në rritjen e kompetencave. Mësimdhënia dhe të nxënëti e integruar. Mësimdhënia dhe të nxënëti e diferencuar.	Gjuhë shqipe; Matematikë Edukatë figurative; Njeriu dhe natyra; Shoqëria dhe mjedisi; Shkathësi për jetë; Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti. Çështjet ndërkurrikulare: Të drejtat e fëmijëve; Çështjet e barazisë gjinore.	Edukatë muzikore 3; CD https://www.youtube.com/watch?v=BF-hoHL0nGhk https://www.youtube.com/watch?v=X-4QaKvZqzX4 https://www.youtube.com/watch?v=yrCE-qdMfbno
-	- Këndon ose luan në instrumente fëmijërore ndonjë krijim origjinal të shkurtër.	28. Dinamika 29. Vlerësim i njohurive 30. T'i njohim institucionet kulturore 31. Profesionet: Kompozitori, dirigjenti, interpretuesit 32. Krijojmë dhe interpretojmë: Kompozitorët e vegjël 33. Të këndojmë: "Xixëllonja" 34. Gjëgjëza 35. Të ndërtojmë instrumente 36. Të këndojmë: "Ëndrra dhe dëshira" 37. Të këndojmë: "Pesat në librezë" 38. Përmbledhje e punës	Nr. i orëve 11	Mësimdhënia dhe të nxënëti me fëmijët në qendër dhe gjithëpërfshirja. Mësimdhënia dhe të nxënëti e bazuar në rritjen e kompetencave. Mësimdhënia dhe të nxënëti e integruar. Mësimdhënia dhe të nxënëti e diferencuar.	Gjuhë shqipe; Matematikë Edukatë figurative; Njeriu dhe natyra; Shoqëria dhe mjedisi; Shkathësi për jetë; Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti. Çështjet ndërkurrikulare: Të drejtat e fëmijëve; Çështjet e barazisë gjinore.	Edukatë muzikore 3; CD https://www.youtube.com/watch?v=BF-hoHL0nGhk https://www.youtube.com/watch?v=X-4QaKvZqzX4 https://www.youtube.com/watch?v=yrCE-qdMfbno
-	- Identifikon ndonjë figurë markante nga krijuesit dhe performuesit artistikë botërorë dhe vendorë. Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetanake dhe të të tjerëve me fjalor e terma adekuatë.	28. Dinamika 29. Vlerësim i njohurive 30. T'i njohim institucionet kulturore 31. Profesionet: Kompozitori, dirigjenti, interpretuesit 32. Krijojmë dhe interpretojmë: Kompozitorët e vegjël 33. Të këndojmë: "Xixëllonja" 34. Gjëgjëza 35. Të ndërtojmë instrumente 36. Të këndojmë: "Ëndrra dhe dëshira" 37. Të këndojmë: "Pesat në librezë" 38. Përmbledhje e punës	Nr. i orëve 11	Mësimdhënia dhe të nxënëti me fëmijët në qendër dhe gjithëpërfshirja. Mësimdhënia dhe të nxënëti e bazuar në rritjen e kompetencave. Mësimdhënia dhe të nxënëti e integruar. Mësimdhënia dhe të nxënëti e diferencuar.	Gjuhë shqipe; Matematikë Edukatë figurative; Njeriu dhe natyra; Shoqëria dhe mjedisi; Shkathësi për jetë; Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti. Çështjet ndërkurrikulare: Të drejtat e fëmijëve; Çështjet e barazisë gjinore.	Edukatë muzikore 3; CD https://www.youtube.com/watch?v=BF-hoHL0nGhk https://www.youtube.com/watch?v=X-4QaKvZqzX4 https://www.youtube.com/watch?v=yrCE-qdMfbno

Mësimi 1

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Këngët

Rezultatet e të nxënit të temës:

Këndon dhe interpreton në instrumente.
Shoqëron këndimin me zë, me duar.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.5; III.4; III.9; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: “Zilja jonë”

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Këndon këngën duke zbatuar rregullat e këndimit.
- Shoqëron këngën me duar duke kënduar grupi.
- Paraqet në pentagram notat e këngës muzikore sipas udhëzimeve të mësuesit/es.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD-ja, projektori, laptopi, pentagrami.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja paraqet në projektor një fotografi. Detyrë e nxënësve është që ta analizojnë.

Parashtrihen disa pyetje për të nxitur diskutimin:

- Çfarë po shihni në fotografi?
- Kush i fton nxënësit që të futen brenda?

Mendimet e nxënësve diskutohen me klasën.



“Zilja jonë”


CD 1

Shpejt

Muzika: Fahri Beqiri

Tring e tring kjo zi - lja jon' për në m'sim a - jo na fton
e - ni nxë - nës me nxi - tim na th'rrret shko - lla gjith' gë - zim


Klasa ime feston sot
Është si pula me gjith zogj'
Na uron që dhe këtë her'
T'kem plot pesa në ditar'



Përsëritini këngët e mësuara më parë, duke i shoqëruar ato me instrumente ritmike, me duartrokitje apo edhe me lëvizje trupore.



1. Cili ishte momenti më i bukur i kësaj vere?
2. Cilët libra i ke lexuar gjatë këtij pushimi të verës?



Fahri Beqiri

Fahri Beqiri ishte njëri nga kompozitorët e parë në Kosovë.
Ai ka kompozuar shumë këngë dhe muzikë instrumentale për fëmijë.

10





Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Dëgjim i drejtuar

Aktiviteti 1: Nxënësit njoftohen me këngën që do ta mësojnë. Titulli “**Zilja jonë**” paraqitet përmes projektorit (titulli shkruhet në tabelë në mungesë të projektorit).

Pastaj kënga e ndarë në strofa paraqitet në tabelë. Mësohet kënga strofë për strofë.

Aktiviteti 2: Lëshohet kënga në CD dhe dëgjohet me vëmendje interpretimi i këngës.

Aktiviteti 3: Njoftohen nxënësit se kënga këndohet sipas rregullave:

Një nxënës këndon këngën, kurse nxënësit e tjerë e shoqërojnë me duar.

Nxënësit individualisht dhe në grup këndojnë këngën e mësuar, duke e shoqëruar me zë dhe me duar.



Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Vizatim

Te kjo pjesë e orës mësimore kërkohet nga nxënësit që në pentagram të paraqesin këngën me notat muzikore.

Puna e tyre monitorohet dhe ndihmohet.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, mënyrën e interpretimit të këngës dhe vizualizimin e ditës së parë të shkollës.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin këngën me notat muzikore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 2

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Elementet bazike të gjuhës artistike

Rezultatet e të nxënit të temës:

Njih notacionin grafik për disa nga vetitë themelore të tingullit muzikor, (lartësitë dhe gjatësitë tingullore).

Dallon disa dukuri muzikore ritmike e melodike në këngët e kënduara dhe në veprat e dëguara.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.4; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Tingulli i gjatë dhe tingulli i shkurtër

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton saktë rrokjet e gjata dhe të shkurtra në tekstin e dhënë.
- Identifikon rrokjet e gjata dhe të shkurtra në këngën e paraqitur.
- Këndon këngën duke u bazuar në rregullat e këndimit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim i njohurive para-prake

Nxënësve u drejtohen pyetjet:

Çfarë është tingulli?


Sa lloje të tingujve kemi?

Kur është një tingull i gjatë?




Njohuri

Tingulli i gjatë dhe tingulli i shkurtër



Ligjëroje tekstin duke emërtuar rrokjet e gjata me **NA** dhe rrokjet e shkurtra me **NI**. Mund të ndaheni në dy grupe: grupi i parë e këndon melodinë, ndërsa grupi tjetër e shoqëron atë me instrumente ritmike, duartrokitje etj.





“Flutura dhe bilbili”

Në ilustrim vëreni se disa flutura janë më të mëdha se të tjerat. Nga ajo që kemi parë deri më tani, kuptojmë se fluturat e vogla zgjasin më shkurt se fluturat e mëdha.

Po ashtu, fluturat në vijë këndohen në lartësinë e notës **MI**, fluturat nën vijë këndohen me tingull më të ulët, me notën **RE**.

Flutur, Flutur



**Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit**

Te kjo pjesë e orës mësimore, në secilin grup vendoset ushtrimi i përgatitur nga vetë mësuesi/ja. Nxënësit kanë për detyrë të bëjnë krahasimin e fluturave të vogla me fluturat e mëdha. Nxënësit këndojnë këngën duke u bazuar në vizatimin që kanë para.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, mënyrën e interpretimit të këngës.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin këngën me notat muzikore.

Reflektim për rrezultatin e orës mësimore:

Kur është një tingull i shkurtër?

Diskutohen mendimet e nxënësve.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Dëgjim i drejtuar**

Aktiviteti 1: Nxënësit njoftohen me njësinë e re që do ta mësojnë. Titulli **“Tingulli i gjatë dhe tingulli i shkurtër”** paraqitet përmes projektorit (titulli shkruhet në tabelë në mungesë të projektorit).

Aktiviteti 2: Nxënësit kanë për detyrë që të emërtojnë rrokjet e gjata me **Na** dhe rrokjet e shkurtra me **Ni**.

Aktiviteti 3: Nxënësit ndahen në dy grupe. Grupi i parë ka për detyrë që të gjejë rrokjet e gjata, kurse grupi i dytë rrokjet e shkurtra.

Aktiviteti 4: Njoftohen nxënësit se kënga këndohet sipas rregullave. Grupi i parë këndon melodinë, ndërsa grupi tjetër e shoqëron atë me instrumente ritmike, duartrokitje etj.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë muzikore
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Elementet bazike të gjuhës artistike

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Njeh notacionin grafik për disa nga vetitë themelore të tingullit muzikor (lartësitë dhe gjatësitë tingullore).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.5; III.4; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Të rikujtojmë çelësin sol

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Bashkon pikat sipas radhës për të formuar çelësin sol.
 - Krijon çelësin sol me mjete ricikluese.
 - Jep mendime të sakta për çelësin sol.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, teli, fongoja, plastika.



Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
 Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja parashtron disa pyetje për të nxitur diskutimin.
Çfarë po shihni në fotografi?
Çfarë dini për të?
Në cilën fushë fillon?
 Mendimet e nxënësve diskutohen me klasën.

Të rikujtojmë çelësin sol





Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Dëgjim i drejtuar

Në këtë pjesë të orës mësimore nxënësit mësojnë për historikun e çelësit muzikor.

Aktiviteti 1: Nxënësit mësojnë për historikun e çelësit muzikor.

Aktiviteti 2: Secilit nxënës në mënyrë individuale i shpërndahet ushtrimi i përgatitur. Detyrë e nxënësve është që, duke bashkuar numrat, të zbulojnë çelësin muzikor.

Aktiviteti 3: Nxënësit punojnë çelësin muzikor me mjete ricikluese që i kanë sjellë nga shtëpia. Zgjidhet punimi më i mirë.



Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit

Pas mbarimit të punës, krijimet ekspozohen në grupe. Secili nxënës bën shpjegimin e krijimit të tij, duke folur me gjuhë të thjeshtë artistike. Veçohen punimet më të bukura.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përshkrimit të çelësit muzikor.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin notat dhe çelësin muzikor.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë muzikore
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Elementet bazike të gjuhës artistike

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Përjeton dhe dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur-mol) në këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.4; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: “Shiu pikëlon”

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Interpreton këngën duke u bazuar në atë që dëgjon.
- Imiton me saktësi njëren nga kërkesat: piklat e shiut, qenushin ose krahët e zogut pas shiut.
- Paraqet njëren nga këngët përmes figurave gjeometrike në pentagram.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD-ja, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
 Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë

Mësuesi/ja paraqet në tabelë përmes projektorit këtë figurë dhe paraqet pyetjet:
Çfarë po shohim?

*Ku është i vendosur drejtkëndëshi i kaltër? Drejtkëndëshi i kuq?
 Po drejtkëndëshi i verdhë?*

Pasi marrim përgjigjet nga nxënësit, nën të shkruan notat: **FA** - paraqet ngjyrën e kaltër; **MI** - paraqet ngjyrën e kuqe dhe **RE** - paraqet ngjyrën e verdhë.





Luajmë

Përmes këtij ushtrimi, do t'i imitojmë pikat e shiut së bashku. Çdo pikë shiu ka ritmin dhe kohëzgjatjen e vet. Le të imagjinojmë se si tingëllojnë ato kur pikëlojnë në dritaret tona.

- Disa pika janë më të mëdha dhe disa më të vogla.
- **Kujdes!** Përcill format dhe kohëzgjatjen, në mënyrë që ligjërimi të jetë i saktë.
- Ngjyrat do të të ndihmojnë që ta këndosh me saktësi ushtrimin.



"Vjeshta"

CD 4



Tra la la
Tra la la



tri li li
tri li li



po fryn' e - ra bi - e shi
er - dhi vjesh - ta o fë - mij'



1. Luaj me këtë këngë duke imituar pikat e shiut që bien te dritarja jote.
2. Imito qenushin ose zogjtë se si shkundin krahët e tyre pas shiut.

17



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Dëgjim i drejtuar

Aktiviteti 1: Nxënësit njoftohen me këngën që do ta mësojnë. Titulli "Shiu pikëlon" paraqitet përmes projektorit (titulli shkruhet në tabelë në mungesë të projektorit).

Pastaj kënga e ndarë në strofa paraqitet në tabelë. Mësohet kënga strofë për strofë.

Aktiviteti 2: Lëshohet kënga në CD dhe dëgjohet me vëmendje interpretimi i këngës.

Nxënësit ndahen në dy grupe: njëri grup imiton pikat e shiut, kurse grupi tjetër imiton qenushin ose zogjtë se si shkundin krahët e tyre, pas shiut.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Udhëzohen të paraqesin këngën në pentagram me anë të figurave gjeometrike, sipas ngjyrave që simbolizojnë notat muzikore: Re, Mi, Fa, duke u bazuar në tekst.

Puna e nxënësve monitorohet dhe ndihmohet.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, mënyrën e interpretimit të këngës.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin këngën me notat muzikore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 5

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Këngët

Rezultatet e të nxënit të temës:

Këndon dhe shoqëron këndimin me zë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.5; III.4; III.9; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: “Troket vjeshta”

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Këndon këngën me intonacion, duke imituar atë që dëgjon.
- Përgjigjet saktë në pyetjet e parashtruara rreth këngës.
- Vizaton me saktësi elementet që paraqesin stinën e parapëlqyer.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD-ja me këngën “Troket vjeshta”.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Diskutim i njohurive paraprake

Nxënësve u drejtohen pyetjet:

Sa stinë ka viti?

Cilat janë ato?

Në cilën stinë jemi?

Pas cilës stinë vjen stina e vjeshtës?

Cila stinë ju pëlqen më së shumti?

Diskutohet rreth përgjigjeve të nxënësve.



“Troket vjeshta”

Muzika: Kujtim Mullai
Teksti: Kujtim Mullai



Kur një stinë lodhet,
vallja rrotullohet,
dimrin ndërton pranvera,
dhe pranverën vera.

Stinët vejnë e vijnë,
përqafuar rrinë,
s'ka frutë e s'ka bimë,
ta bëjë një stinë.



A e dini se:

Pse pema lëshon gjethet?

Në stinët e vjeshtës dhe të dimrit, zakonisht bën ftohtë dhe ditët nuk janë me shumë diell. Kështu, bimët, ashtu sikur edhe ne, kanë nevojë për energji. Prandaj në vend që të përpiqen t'i mbajnë gjethet e tyre, disa bimë i lëshojnë ato.



1. Cilat janë ngjyrat e vjeshtës?

2. Pse gjethet ndërrojnë ngjyrën në stinën e vjeshtës?

3. Kur mbaron stina e verës dhe kur fillon ajo e vjeshtës?



Detyra

Ky është këndi yt

- Shkruaj shkurtimisht emocionet që përjetove nga vargjet e këngës.

Blank space for writing answers to the first task.

- Vizato dhe më pas ngjyros pamje të natyrës gjatë stinës sate më të pëlqyer.

Blank space for drawing and coloring a nature scene.

19



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Dëgjim i drejtuar

Dëgjohet kënga me ndalesa. Pas çdo ndalese, mësuesi/ja nxënësve u drejton pyetje rreth përmbajtjes së këngës.

Pastaj lëshohet CD-ja me strofën e parë.

Nxënësit së bashku këndojnë strofën e parë, duke e përcjellë atë që dëgjojnë. Përsëritet disa herë derisa ta përvetësojnë këngën.

Pyetjet:

Kush trokiti në derë?

A e hapi derën menjëherë Vera?

Pse? Po ju si veproni?

Kështu vazhdohet edhe me strofën e dytë.

Interpretojnë së bashku strofën e parë dhe të dytë.

Pyetjet:

Pse ndërrohen stinët? Kush e ndërrohet Pranverën?

Po Verën, kush e ndërrohet?

A lodheni ju ndonjëherë?

Kush ju ndërrohet ju?

Vazhdojmë me dëgjimin e strofës së tretë.

Nxënësit këndojnë strofën e tretë.

Pastaj këngën e plotë e këndojnë së bashku.

Pyeten:

Çka ju pëlqeu më së shumti në këtë këngë? Pse?



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënësve

Vizatim

Udhëzohen të hapin librat fq. 17, ku përmes disa elementeve vizatojnë stinën që u pëlqen më së shumti. Puna e tyre monitorohet dhe ndihmohet.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, mënyrën e interpretimit të këngës dhe vizualizimin e stinës së pëlqyer.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin këngën me notat muzikore.

Blank space for musical notation, with a decorative border and a small illustration of a musical instrument.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Krijuesit dhe performuesit

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon ndonjë figurë markante nga krijuesit dhe performuesit artistikë botërorë dhe vendorë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.3; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Këndojmë bukur

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Numëron tri rregullat e këndimit.
- Shqipton saktë zanoret duke respektuar rregullat e këndimit.
- Shkruan të përbashkëtat dhe dallimet mes solistit dhe korit nga ajo që dëgjojnë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD-ja, fletët A4 me Diagramin e Venit.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja parashtron një pyetje për të nxitur diskutimin.

Cili është dallimi në mes solistit, korit të të rriturve dhe korit të fëmijëve?

Nxënësit në grupe gjejnë përgjigjen e pyetjes së dhënë.

Mendimet e nxënësve diskutohen me klasën.




Njohuri

Këndojmë bukur

Mbaje në mend!

Për zërin thuhet se është *instrumenti më i përsosur*. Që të këndosh bukur, duhet të kesh kujdes që, gjatë këndimit, qoftë kur je ulur apo kur qëndron në këmbë, duhet:

- të qëndrosh drejt;
- të kesh frymëmarrje të rregullt dhe të mjaftueshme;
- t'i shqiptosh drejt fjalët.



- Duhet të kesh kujdes në shqiptimin e drejtë të të gjitha vokaleve: **a, o, i, e, u, y, ë**.



- Provo të bësh shqiptimin e saktë të çdo vokali veç e veç, nën mbikëqyrjen e mësuesit/es.



Njohuri

Solisti dhe kori

Nëse këngëtarë këndojnë vetëm, atëherë atë e quajmë **solist/e**, por, nëse një numër i madh këngëtarësh këndojnë bashkërisht, atëherë atë grup këngëtarësh e quajmë **kor**.

Talentin tuaj ju do ta shprehni me këndimin në klasë. Por, nëse këndoni bukur, ju do të zgjidheni për të kënduar edhe në *Korin e shkollës*.



CD 5, 6, 7



T'i dëgjojmë shembujt

- 5. **Edvard Grieg:** "Solveigs Song"
- 6. **Rexho Mulliqi:** "Vjeshta" - korale.
- 7. "Hapa-dollapa" - kori i fëmijëve **Xixëllonjat**.



1. Bëni dallimin në mes **solistit, korit të të rriturve** dhe **korit të fëmijëve**.

21



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Dëgjim i drejtuar

Në këtë veprimtari kërkohet nga nxënësit që të hapin tekstin shkollor.

Aktiviteti 1: Nxënësit mësojnë se zëri është instrumenti më i përsosur. Që të këndosh bukur, duhet të kesh kujdes që, gjatë këndimit, qoftë kur je ulur apo kur qëndron në këmbë, duhet:

- të qëndrosh drejt;
- të kesh frymëmarrje të rregullt dhe të mjaftueshme;
- t'i shqiptosh drejt fjalët.

Aktiviteti 2: Provojnë individualisht të bëjnë shqiptimin e saktë të çdo vokali veç e veç, nën mbikëqyrjen e mësuesit/es.

Aktiviteti 3: Dëgjojnë shembujt:

Edvard Grieg: "Solveigs Song" për solist dhe orkestër.


Rexho Mulliqi: "Vjeshta" për kor.
"Hapa-dollapa" për kor fëmijësh.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënët

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja shpërndan ushtrimin e përgatitur. Detyrë e nxënësve është që të gjejnë të përbashkëtat dhe dallimet mes stolistit dhe korit. Puna e tyre monitorohet, ndihmohet dhe prezantohet.

Stolisti Të përbashkëtat Kori



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, për shqiptimin e drejtë të të gjitha vokaleve.

Detyrë:

Mësojnë këngën "Hapa dollapa".

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Instrumentet muzikore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizualisht.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.5; III.4; V.8; VI.2,3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Instrumentet ritmike popullore

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shoqëron me ndonjërin nga instrumentet këngën “Zilja jonë”.
- Identifikon instrumentet popullore, duke i rrethuar ato.
- Emërton saktë instrumentin, pas shembujve të dhënë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: instrumentet e ORF-it.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja parashtron disa pyetje për të nxitur diskutimin.

Cilat janë instrumentet ritmike popullore?

A luan ndokush njërin nga këto instrumente?

A mund të shoqërohet këndimi me to?

Mendimet e nxënësve diskutohen me klasën.




Njohuri

Instrumentet ritmike popullore

Populli ynë ka traditë të ndërtimit të instrumenteve, me të cilat ka shoqëruar këndimin. Instrumentet me të goditur (instrumentet ritmike) i gjejmë shpesh në përdorim.

Ja disa prej tyre:



CD 8



- Dëgjo me vëmendje tingujt e instrumenteve dhe trego se për cilin instrument bëhet fjalë.
- Demonstro dhe përshkruaj se si luhet në instrumente. A luan dikush nga ju në ndonjërin nga këto instrumente?



Njohuri

Luajmë: Kënga “Zilja jonë”


Këngën që ju më parë e keni mësuar - “Zilja jonë”, mund ta shoqëroni me ndonjërin prej këtyre instrumenteve ritmike.

“Zilja jonë”



Grupi i instrumenteve (ritmike) të Orff-it

Instrumentariumi i Orff-it përbëhet prej grupit të instrumenteve melodike (**ksilofoni, metalofoni, blokflauti** etj.) dhe prej grupit të instrumenteve ritmike, numri i të cilave është i madh. Pikërisht instrumentet ritmike të Orff-it, shumë shpesh i gjejmë në përbërje të orkestrinave shkollore. Ndër to veçohen: **triangli, kastanjeta, pjabat (çinelat), lodra e vogël, shkopinjët, marakasi** etj.



CD 9



- Dëgjoni me vëmendje shembujt e instrumenteve.
- Pasi t'i keni dëgjuar shembujt me përsëritje, provoni t'i identifikoni instrumentet.

23



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Dëgjim i drejtuar

Aktiviteti 1: Këngën që kanë mësuar më parë - “Zilja jonë”, mund ta shoqërojnë me ndonjërin prej instrumenteve ritmike.

Aktiviteti 2: Nxënësit gjejnë instrumentet më ritmike popullore. Puna e tyre prezantohet.

Aktiviteti 3: Demonstrjnë dhe përshkruajnë se si luhet në instrumente.

Aktiviteti 4: Pyeten nxënësit nëse luan dikush nga ta në ndonjërin nga këto instrumente.

Mendimet e tyre diskutohen me klasën.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Këndohen këngë të mësuar paraprakisht që vetë nxënësit i kanë përzgjedhur. Këndimi i këngëve bëhet me përcjellje të instrumenteve të punuara nga ta apo edhe të instrumenteve që mund të sigurohen për klasën. Në këtë mënyrë kanë mundësi të bëjnë dallimin e tingujve përmes këndimit, në bazë të ritmit dhe melodisë së këngës.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, shoqërimin e këngës me instrument muzikor.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin këngën me notat muzikore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Elementet bazike të gjuhës artistike

Rezultatet e të nxënit të temës:

Njih notacionin grafik për disa nga vetitë themelore të tingullit muzikor.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.4; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vlerat e notave

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon së paku tri vlera në këngën e dhënë.
- Emërton vlerat e identifikuar në këngën e dhënë.
- Paraqet në pentagram të gjitha notat e identifikuar.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: pentagrami, libri.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit ndahen në grupe. Në secilin grup, mësuesi/ja shpërndan notat muzikore dhe vlerat e ndryshme të tingujve. Detyrë e nxënësve është që të bashkojnë notën me vlerën që i takon. Grupi më i saktë dhe më i shpejtë shpallet fitues.



Njohuri

Vlerat e notave

Te kënga “Shiu pikëlon”, ju keni vërejtur dallimin mes tingullit të gjatë dhe tingullit të shkurtër. Kjo tregon që në muzikë ka vlera të ndryshme të notave.

“Shiu pikëlon”


Qetësisht



Shohim se në këtë këngë i kemi tri vlera të ndryshme të tingujve, të cilat i emërtojmë kështu:

	Nota gjysmë		Pushimi gjysmë
	Nota katërshe		Pushimi katërshe
	Nota tetëshe		Pushimi tetësh

Kemi edhe vlera më të mëdha



Notat tetëshe i shënojmë në dy mënyra:


Të ndara veç e veç
Vlerat e notave me flamur



ose të lidhura me vijë horizontale
Vlerat e notave të lidhura



“Vjeshta”



25



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Mendo - puno - thuaja grupit

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit vazhdojnë punën në grupe.

Aktiviteti 1: Në secilin grup shpërndahet kënga “Shiu pikëlon”. Nxënësit gjejnë tri vlera të ndryshme të tingujve.

Aktiviteti 2: Emërtojnë vlerat e tingujve të ndryshëm që kanë gjetur.

Puna e secilit grup prezantohet.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit shkruajnë në pentagram vlerat e notave që kanë zbuluar.

Puna e tyre monitorohet dhe ndihmohet.

Vlerësimi i nxënësve:

U kërkohet nxënësve saktësia në emërtimin dhe identifikimin, mënyrën e prezantimit të detyrës.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin këngën me notat muzikore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë muzikore
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Elementet bazike të gjuhës artistike

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përjeton dhe dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur-mol) në këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.1; III. 3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Cakto notat katërshe dhe notat tetëshe!

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Vendos saktë notën katërshe dhe tetëshe në ushtrimin e përgatitur.
- Këndon këngën rrjedhshëm duke ndjekur notën katërshe dhe tetëshe.
- Plotëson Diagramin e Venit me së paku një dallim dhe një të përbashkët që kanë notat katërshe dhe tetëshe.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD-ja, fletë A4 të përgatitura me Diagramin e Venit.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim i njohurive paraprake

Mësuesi/ja fillimisht paraqet përmes projektorit skemën e mëposhtme.

Brenda rrethit shkruan “Notat”.



Detyra

Cakto notat katërshe dhe notat tetëshe!

Kam një qengj sy - la - rosh e ka em - rin bu - ku - rosh

Bi - e bor' kën - don stu - fa në stuf' fla - ka tu - fa tu - fa

Bu - çet zja - rri bu - bu - bu mbush - ma go - jën plot me dru



26




"Zemra bën tik-tak"

Two musical staves illustrating the 'tik-tak' rhythm. The first staff shows notes for 'Tik tik a është a po' and 'Tak tak zem - ra or''. The second staff shows notes for 'Tik tik zem - ra është e' and 'Tak tak dlir''.



Siç mund të vëreni, në këngën "Zemra bën tik-tak" na shfaqet edhe një lartësi. Tingulli i parë, **TIK**, qenka në vizën e dytë, ndërsa tingulli i dytë, **TAK**, i vendosur në vijën ndihmëse, poshtë pentagramit.

Mendimet e nxënësve shkruhen në secilin drejtkëndësh. Varësisht prej kohës, disa prej tyre lexohen.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Dëgjim i drejtuar

Në këtë pjesë të orës mësimore nxënësit ndahen në grupe.

Aktiviteti 1: Në secilin grup vendoset ushtrimi i përgatitur nga vetë mësuesi/ja. Detyrë e nxënësve është që në ushtrimin e dhënë të caktojnë notën katërshe dhe notën tetëshe.

Aktiviteti 2: Te kjo pjesë e orës mësimore, nxënësit në bashkëpunim me mësuesin/en


ushtrojnë këndimin e këngës sipas notave katërshe dhe tetëshe.



Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit ndahen në grupe. Nxënësit në grupe kanë për detyrë që të gjejnë dallimet dhe të përbashkëtat e notës katërshe dhe notës tetëshe. Puna e tyre monitorohet dhe ndihmohet. Prezantohet puna e nxënësve.

Nota katërshe Të përbashkëtat Nota tetëshe



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve dhe caktimin e notës katërshe dhe notës tetëshe.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin këngën me notat muzikore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 10

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Lojërat muzikore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Luan lojëra të thjeshta muzikore, të shoqëruara me këngë, të cilat kanë gjuhën shprehëse të përshtatshme me fjalorin e moshës së tyre, të përcjella me lëvizje trupore e me vegla muzikore femijërore dhe që trajtojnë tema të ndryshme, por edhe elemente didaktike të gjuhës artistike muzikore (ritmi, melodia, vetitë e tingullit muzikor etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.5; III.4; V.8; VI.2,3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5,7.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: “Zemra bën tik-tak”

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Luan lojëra të thjeshta duke e shoqëruar me këngën e dëgjuar.
- Përcjell ritmin duke kënduar shoku/shoqja.
- Emërton saktë notat që gjenden në pentagramin e tekstit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: projektori, laptopi, CD-ja.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit


Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë pjesë të orës mësimore nxënësit ndahen në grupe.

Mësuesi/ja në secilin grup shpërndan ushtrimin e përgatitur nga vetë ai/ajo.



“Zemra bën tik-tak”



Siç mund të vëreni, në këngën “Zemra bën tik-tak” na shfaqet edhe një lartësi. Tingulli i parë, **TIK**, qenka në vizën e dytë, ndërsa tingulli i dytë, **TAK**, i vendosur në vijën ndihmëse, poshtë pentagramit.



27

Njohuri



CD 10

"Zemra bën tik-tak"



Sic mund të vëreni, në këngën "Zemra bën tik-tak" na shfaqet edhe një lartësi. Tingulli i parë, **TIK**, qenka në vizën e dytë, ndërsa tingulli i dytë, **TAK**, i vendosur në vijën ndihmëse, poshtë pentagramit.

27

Detyrë e nxënësve është që të gjejnë se në cilën vizë është vendosur tingulli i parë TIK dhe në cilën vizë tingulli i dytë TAK.

Puna e tyre monitorohet, ndihmohet dhe prezantohet.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Dëgjim i drejtuar

Aktiviteti 1: Nxënësit njoftohen me këngën që do ta mësojnë. Titulli "**Flutura dhe bilbili**" paraqitet përmes projektorit (titulli shkruhet në tabelë në mungesë të projektorit). Pastaj kënga e ndarë në strofa paraqitet në tabelë. Mësohet kënga strofë për strofë.

Aktiviteti 2: Lëshohet kënga në CD dhe dëgjohet me vëmendje interpretimi i këngës.

Aktiviteti 3: Njoftohen nxënësit se kënga këndohet sipas rregullave: Një nxënës këndon këngën, kurse nxënësit e tjerë e shoqërojnë me duar. Nxënësit individualisht dhe në grup këndojnë këngën e mësuar, duke e shoqëruar me zë dhe me duar.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Në këtë pjesë të orës mësimore nxënësit kanë për detyrë që të emërtojnë notat muzikore që janë në pentagram.

Puna e tyre monitorohet dhe ndihmohet. Varësisht prej kohës, disa prej tyre prezantohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e dallimit të tingullit të parë TIK dhe tingullit të dytë TAK.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin këngën me notat muzikore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Krijuesit dhe performuesit

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon ndonjë figurë markante nga krijuesit dhe performuesit artistikë, botërorë dhe vendorë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.3; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Skënderbeu në veprat muzikore - Ç' është orkestra?

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përmend së paku një kompozitor që i ka kushtuar një vepër Skënderbeut.
- Përcakton saktë veprën që i është kushtuar Skënderbeut.
- Emërton instrumentet që bëjnë pjesë në orkestër.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, CD-ja, fotografi të kompozitorëve.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim i njohurive paraprake

Skënderbeu

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi i shpërndan secilit nxënë ushtrimin e përgatitur nga vetë ai. Detyrë e nxënësve është që të gjejnë dy mbiemra, tri folje, një fjali dhe një emër ndryshe për Skënderbeun.


Skënderbeu në veprat muzikore

Heroi ynë kombëtar, Skënderbeu, nxiti shumë kompozitorë të mëdhenj të huaj t'i kushtonin vepra të tëra. Opera e parë për të u kompozua nga kompozitori i famshëm, Antonio Vivaldi.



Po ashtu, shumë kompozitorë shqiptarë i kanë kushtuar vepra të tëra heroit tonë, Skënderbeut, si: Fan Noli, Prenk Jakova, Çesk Zadeja, Aleksandër Peçi, Mark Kaçinari etj. Ndër këto vepra veçohet poema dramatike "Skënderbeu" e kompozitorit kosovar Fahri Beqiri.

Ja tema me të cilën kompozitori e përshkruan ardhjen e Skënderbeut:





Njohuri

Ç'është orkestra?

Orkestra paraqet një grup të interpretuesve që luajnë bashkërisht. Në përbërje të orkestrës hyjnë: instrumentet harkore, instrumentet frymore dhe instrumentet me goditje (instrumentet ritmike).



CD 29, 30

- 29. Fahri Beqiri: Poema simfonike "Skënderbeu".
- 30. Antonio Vivaldi: Fragment nga opera "Scanderbeg".

47



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Mendo - puno - thuaja grupit

Aktiviteti 1: Përmendin disa kompozitorë shqiptarë, që i kanë kushtuar vepra të tëra heroit tonë, Skënderbeut.

Aktiviteti 2: Nxënësit tregojnë se cila ishte tema me të cilën kompozitori e përshkruan ardhjen e Skënderbeut.

Aktiviteti 3: Nxënësit tregojnë se çfarë paraqet orkestra dhe cilat instrumente hyjnë në përbërjen e orkestrës.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit vizatojnë instrumentet që bëjnë pjesë në orkestër. Puna e tyre ekspozohet dhe vlerësohet.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, gjetjen e kompozitorëve që kanë shkruar për Skënderbeun.

Detyrë:

Të shkruajnë për biografinë e Skënderbeut.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë muzikore
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Elementet bazike të gjuhës artistike

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Njeh notacionin grafik për disa nga vetitë themelore të tingullit muzikor (lartësitë dhe gjatësitë tingullore).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.4; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Tingulli i lartë dhe tingulli i ulët

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Imiton me lëvizje tingullin e ulët dhe tingullin e lartë nga ajo që dëgjon.
- Dallon tingullin e ulët dhe tingullin e lartë, duke përdorur ngjyra të ndryshme në bazë të udhëzimeve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD-ja, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
 Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Diskutim i njohurive paraprake


Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë fotot në tekst; me ngjyrë të verdhë ta rrethojnë burimin që ka tingull të ulët, kurse me ngjyrë të kaltër ta rrethojnë burimin që ka tingull të lartë. Pastaj argumentojnë mendimet e tyre.



Njohuri

Tingulli i lartë dhe tingulli i ulët

Tingujt që ne i ndeshim në jetën tonë të përditshme kanë veçori të ndryshme. Dallojmë tingujt e gjatë dhe tingujt e shkurtër, por dallojmë edhe tinguj të ulët dhe tinguj të lartë. Ne i dëgjojmë tingujt e **bubullimës** dhe **aeroplanit** dhe themi se janë tinguj të ulët, ndërsa për tingujt e bletës apo për **cicërimën e zogut** themi se janë tinguj të lartë.





Edhe në muzikë ne dallojmë tinguj të lartë dhe tinguj të ulët. Kështu, dallojmë instrumentet që e kanë tingullin e ulët dhe instrumentet e tjera që e kanë tingullin e lartë.



- Pasi ta dëgjoni kompozimin për piano “Bleta dhe Ariu”, tregoni se cila melodi tregon ariun e cila bletën.
- Imitoni me lëvizje melodinë që po dëgjoni.
- Kur dëgjoni melodinë e lartë, ngrini fletët me ngjyrë të çelët, ndërsa me të dëgjuar melodinë me zërin e ulët, ngrini fletën me ngjyrë të mbyllur.



Detyra

1. Provo të gjesh tinguj të tjerë të lartë dhe tinguj të ulët, që ty të rrethojnë në përditshmërinë tënde!
2. Provo, me zërin tënd, të fitosh tingullin e lartë dhe tingullin e ulët!



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Dëgjim i drejtuar

Aktiviteti 1: Pasi ta dëgjoni kompozimin për piano “Bleta dhe Ariu”, tregojnë se cila melodi tregon ariun, e cila bletën.

Aktiviteti 2: Imitojnë me lëvizje melodinë që dëgjojnë.

Aktiviteti 3: Kur dëgjojnë melodinë e lartë, ngrenë fletën me ngjyrë të çelët, ndërsa me të dëgjuar melodinë me zërin e ulët, ngrenë fletën me ngjyrë të mbyllur.



Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit provojnë të gjejnë tinguj të tjerë të lartë dhe tinguj të ulët, që ata i rrethojnë në përditshmërinë e tyre.

Provojnë, me zërin e tyre, të fitojnë tingullin e lartë dhe tingullin e ulët.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për gjetjen e tingujve të ulët dhe të lartë.

Detyrë:

Të krijojnë tinguj të ulët dhe të lartë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Instrumentet muzikore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon ngjyrën tingullore të instrumenteve muzikore (popullore dhe klasike) përmes dëgjimit të veprave muzikore të përshtatshme për moshën e tyre.

Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizualisht.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.5; III.4; V.8; VI.2,3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Muzika vokale dhe muzika instrumentale

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Vendos tik për formën që përdoret në këngën e dëgjuar.
- Identifikon instrumentet muzikore gjatë dëgjimit të këngës.
- Liston karakteristikat e Moxartit duke iu përgjigjur pyetjeve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletët A4, CD-ja apo projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja parashtron një pyetje për të nxitur diskutimin.

Cili është dallimi në mes të muzikës vokale dhe muzikës instrumentale?

Nxënësit në dyshe mendojnë përgjigjen e pyetjes.

Muzika vokale dhe muzika instrumentale

Muzikën mund ta interpretojmë duke **kënduar** dhe duke **luajtur** në instrumente. Muzika që këndohet quhet **muzikë vokale**, ndërsa muzika që luhet në instrumente quhet **muzikë instrumentale**.

CD 13, 14, 15



13. Johann Sebastian Bach: Tokata dhe fuga në d-mol.

14. Wolfgang Amadeus Mozart: Simfonia g-mol për orkestër simfonike (fragment).

15. Rafet Rudi: "Xhike-loke" për kor.




Detyra

1. Dëgjoni në mënyrë të përsëritur këto pjesë muzikore dhe, në bazë të dëgjimit, përpquni ta dalloni se cilin formacion jeni duke dëgjuar: orkestrën, korin, solistin vokal apo solistin instrumentale!
2. Në veprën e Moxartit, dalloni ndonjë prej instrumenteve të përdorura.



Njohuri

Ushtrim ritmik



CD 16, 17



- 16. Joseph Haydn: "Simfonia për fëmijë"
- 17. Mark Kaçinari: "Fyelli i bariut".



Joseph Haydn, është kompozitor austriak, i cili kompozoi shumë vepra për orkestrë, për kor dhe për instrumente të ndryshme. Ndër veprat më të njohura të tij është: "Simfonia për fëmijë" që u dedikohet fëmijëve. Thuhet se kompozitori Haydn (Hajden) e kompozoi këtë vepër pasi kishte blerë disa lodra fëmijësh si dhuratë për festën e Krishtlindjeve dhe për t'i gëzuar fëmijët; ai i kishte përdorur këto lodra si instrumente. Në këtë Simfoni, Hajden në përbërje të orkestrës fut daullën, zilet, fyellin, trekëndëshin etj. Ndër veprat e tij më të mira janë ato të shkruara për piano. Hajdeni ka qenë mësues i kompozitorit Moxarti.



Dyshja më e shpejtë dhe më e saktë shpallet fituese.

Mendimet e nxënësve diskutohen me klasën.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Dëgjim i drejtuar

Aktiviteti 1: Dëgjojnë në mënyrë të përsëritur pjesët muzikore dhe, në bazë të dëgjimit, përpiqen ta dallojnë se cilin formacion janë duke dëgjuar: orkestrën, korin, solistin vokal apo solistin instrumental.

Nxënësve u shpërndahen fletë A4, ku janë të shkruara format e ndryshme që janë duke dëgjuar e të cilave u vendoset një *tik* përpara.

Aktiviteti 2: Në veprën e Moxartit, dallojnë ndonjë prej instrumenteve të përdorura.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit

Te kjo pjesë e orës mësimore, mësuesi/ja i shpërndan secilit nxënës ushtrimin e përgatitur nga vetë ai. Detyrë e nxënësve është që të gjejnë dy mbiemra, tri folje, një fjali dhe një emër ndryshe për Moxartin.

Moxarti

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, dallimin e instrumenteve të përdorura.

Detyrë:

Shkruajnë për biografinë e Moxartit.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë muzikore
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Elementet bazike të gjuhës artistike

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Përjeton dhe dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia durmol) në këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.4; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njëësia mësimore: “Hyri vallja në shtëpi”

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Këndon këngën me intonacion duke imituar atë që dëgjon.
 - Shoqëron këngën me duar derisa këndon shoku.
 - Hijezon notat që janë përdorur më së shumti gjatë këndimit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD-ja, fletët A4 me notat e paraqitura.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
 Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja parashtron një pyetje për të nxitur diskutimin.
Ju kujtohet që në fillim të vitit shkollor ne kemi folur për shtëpinë e notave muzikore? Kemi thënë se në këtë shtëpi të notave çdo tingull e ka emrin dhe vendin e vet.

Si quhet kjo shtëpi? (Pentagram)
 Mendimet e nxënësve diskutohen me klasën.

Njohuri

“Hyri vallja në shtëpi” CD 18

Allegro didaktike

Tra - la - la tri - li - li hy - ri vall - ja në shtë - pi

Tra - la - la tri - li - li po kën - don dhe ba - bi im





Njohuri

Shtëpia e notave muzikore


Ju kujtohet që në fillim të vitit shkollor ne kemi folur për shtëpinë e notave muzikore dhe për çelësin sol. Kemi thënë se në këtë shtëpi të notave çdo tingull e ka emrin dhe vendin e vet. Kjo shtëpi quhet **pentagram**.

Pentagrami ka 5 vija



vija e pestë
vija e katërt
vija e tretë
vija e dytë
vija e parë


dhe 4 hapësira



hapësira e katërt
hapësira e tretë
hapësira e dytë
hapësira e parë

Ashtu si edhe në ilustrim, tingujt vendosen radhë më radhë. Ndonjëri prej tyre është më i ulët dhe ndonjëri më i lartë. Ky varg i tingujve përbëhet nga tetë nota dhe quhet **shkallë muzikore**.

Me ndihmën e mësuesit/es, këndoni notat së bashku.



Do Re Mi Fa Sol La Si Do

Pentagrami

*Pesë vija të gjata
Të gjata - pa mbarim
N'pentagram rrojnë notat
Këtu - deri n'Kinë.
Pentagrami notave
U mban disiplinë,
Se pa disiplinë
S'e ke - melodinë*

(Agim Deva)

35



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive: Përpunimi i përmbajtjes Dëgjim i drejtuar

Aktiviteti 1: Nxënësit njoftohen me këngën që do ta mësojnë. Titulli “**Hyri vallja në shtëpi**” paraqitet përmes projektorit (titulli shkruhet në tabelë në mungesë të projektorit).

Pastaj kënga e ndarë në strofa paraqitet në tabelë. Mësohet kënga strofë për strofë.

Aktiviteti 2: Lëshohet kënga në CD dhe dëgjohet me vëmendje interpretimi i këngës.

Aktiviteti 3: Njoftohen nxënësit se kënga këndohet sipas rregullave:

Një nxënës këndon këngën, kurse nxënësit e tjerë e shoqërojnë me duar. Nxënësit individualisht dhe në grup këndojnë këngën e mësuar, duke e shoqëruar me zë dhe me duar.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit me ndihmën e mësuesit/es, këndojnë notat së gjatë këndimit - LA, SI, DO. Puna e tyre monitorohet dhe ndihmohet.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, mënyrën e interpretimit të notave muzikore.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin çelësin dhe notat muzikore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Këngët

Rezultatet e të nxënit të temës:

Këndon dhe interpreton në instrumente.

Shoqëron këndimin me zë, me duar.

Kontributi në rezultatet për kompetencat

kryesore të shkallës: I.3; II.5; III.4; III.9; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulës: 1.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: “Viti i Ri”

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Këndon këngën duke zbatuar rregullat e këndimit.
- Shoqëron këngën me duar duke kënduar grupi.
- Përgatit njërën nga dhuratat e përzgjedhura për më të dashurin e tyre.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD-ja, printeri, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja parashtron disa pyetje për të nxitur diskutimin.

Trego disa nga gjërat që ke mësuar nga ky vit.

Si do ta kishe përshkruar me një fjali vitin që po e lëmë?

Cila ishte kënga jote më e pëlqyer e vitit që po lëmë pas?

Si duket qyteti yt në prag të festave të fundvitit?

Mendimet e nxënësve diskutohen me klasën.



“Viti i Ri”

CD 19

Muzika: Ylli Kalaja
Teksti: Aulon Kalaja

Kur dë-bo-ra i zbardh ma-jat zja-rrë ndi-zet bu-bu-lak zil-kat zil-kat trin-gë-lloj-në
dre-rët, dre-rët vijn' me vrap Një nga një shpa-lo-sen fle-tët k'tu në ka-len-dar
vjen Dhje-tor, dhje-tor i ëm-bël dri-tat ndi-zen zjarr O sa shum' dhu ra - ta
gij-shi po na bien me dë - bo-rën që po bi - e bar dhë-si - ja vjen





Luajmë

Është festë! Bashkë me shokët dhe shoqet, mund të përgatitni dhurata për njëri-tjetrin, por edhe për anëtarët e familjes së gjerë me gjësende fare të thjeshta. Mund të thurni poezi, të ndërtoni instrumente, syze apo kartolina.

Luani dhe vallëzoni së bashku!



1. Trego disa nga gjërat që ke mësuar nga ky vit.
2. Si do ta kishe përshkruar vitin që po lëmë me një fjali?
3. Cila ishte kënga jote më e pëlqyer e vitit që po lëmë pas?
4. Si duket qyteti yt në prag të festave të fundvitit?

37



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive: Përpunimi i përmbajtjes Dëgjim i drejtuar

Aktiviteti 1: Nxënësit njoftohen me këngën që do ta mësojnë. Titulli “**Viti i ri**” paraqitet përmes projektorit (titulli shkruhet në tabelë në mungesë të projektorit).

Pastaj kënga e ndarë në strofa paraqitet në tabelë. Mësohet kënga strofë për strofë.

Aktiviteti 2: Lëshohet kënga në CD dhe dëgjohe me vëmendje interpretimi këngës.

Aktiviteti 3: Njoftohen nxënësit se kënga këndohet sipas rregullave: Një nxënës këndon këngën, kurse nxënësit e tjerë e shoqërojnë me duar. Nxënësit individualisht dhe në grup këndojnë këngën e mësuar, duke e shoqëruar me zë dhe me duar.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënët

Te kjo pjesë e orës mësimore, nxënësit mund të përgatitnin dhurata për njëri-tjetrin, por edhe për anëtarët e familjes së gjerë me gjësende fare të

thjeshta. Mund të thurin poezi, të ndërtojnë instrumente, syze apo kartolina. Puna e tyre monitorohet dhe ndihmohet.

Luajnë dhe vallëzojnë së bashku.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, mënyrën e interpretimit të këngës dhe dhuratave që kanë përgatitur.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin këngën me notat muzikore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Instrumentet muzikore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizualisht.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.5; III.4; V.8; VI.2,3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ksilofoni - “Zilja tring” - (Jingle Bells)”

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shoqëron me duartrokite këngën zilja tring.
- Identifikon instrumentin e përdorur gjatë dëgjimit të këngës.
- Luan me ksilofon duke përdorur ngjyrat drejt sipas kërkesës në tekst.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: ksilofoni, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja paraqet në projektor një fotografi. Detyrë e nxënësve është që ta analizojnë.

Parashtron disa pyetje për të nxitur diskutimin.

Çfarë po shihni në fotografi?

Si quhet ky instrument muzikor?

Cilit grup të instrumenteve i takon?

Nga çka përbëhet?


Mendimet e nxënësve diskutohen me klasën.



Njohuri

Ksilofoni

Ksilofoni i takon grupit të instrumenteve me goditje. Përbëhet prej pllakëzave (shufrave) të drurit, mbi të cilat goditet me shkopinj. Çdo pllakëz paraqet një notë muzikore. Zakonisht, këto pllakëza kanë ngjyra të ndryshme, që ndihmojnë për ta dalluar çdo notë. Pllakëzat e drurit ndryshojnë për nga madhësia e tyre. Sa më e madhe të jetë pllakëza, aq më i ulët, më i thellë dhe më i trashë do të jetë tingulli.



Luajmë

Të luajmë në bazë të ngjyrave!

Ngjyrat e melodisë do të të ndihmojnë që të luash më lehtë në ksilofon. Dëgjo edhe veprën e krijuar nga kompozitori.



Njohuri

"Zilja tring (Jingle Bells)"

CD 21

Jin-gle bells, jin-gle bells, jin-gle all the way. oh! What fun it is to ride in a
one horse o - pen sleigh! Hey! Jin - gle bells, jin - gle bells, jin - gle all the
way! Oh, what fun it is to ride in a one horse o - pen sleigh.

Ksilofoni

Dy shtagëza t'vogla n'mua trokasin,
Sikur tërë botën në lojë e thërrasin.

Herë-herë as veten nuk e kuptoj
Njëzëzit m'godasin e unë - këndo.

Trupin e drunjtë ma dhuroi mali,
Mjeshtri i mirë zërat m'i fali.

(Agim Deva)

"Twinkle twinkle"

CD 20

Muzika: W.A.Mozart



Detyra

1. Përmes ngjyrave, provoni të luani së bashku në ksilofon.
2. Përcillni ngjyrat në ksilofon sipër tekstit, sepse ato do t'ju ndihmojnë në krijimin e melodisë së saktë. Formoni dy grupe, ku grupi i parë do të luajë në ksilofon, ndërsa grupi i dytë do të këndojë dhe ta shoqërojë me shuplaka.

39



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Dëgjim i drejtuar

Aktiviteti 1: Nxënësit njoftohen me këngën që do ta mësojnë. Titulli Ksilofoni "Zilja tring" paraqitet përmes projektorit (titulli shkruhet në tabelë në mungesë të projektorit).

Pastaj kënga e ndarë në strofa paraqitet në tabelë. Mësohet kënga strofë për strofë.

Aktiviteti 2: Lëshohet kënga në CD dhe dëgjohet me vëmendje interpretimi i këngës.

Aktiviteti 3: Njoftohen nxënësit se kënga këndohet sipas rregullave: Një nxënës këndon këngën, kurse nxënësit e tjerë e shoqërojnë me duar.

Nxënësit individualisht dhe në grup këndojnë këngën e mësuar, duke e shoqëruar me zë dhe me duar.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënët

Te kjo pjesë e orës mësimore, nxënësit përmes ngjyrave, provojnë të luajnë së bashku në ksilofon.

Përcjellin ngjyrat në ksilofon sipër tekstit, sepse ato do t'ju ndihmojnë në krijimin e melodisë së saktë. Formojnë dy grupe, ku grupi i parë do të luajë në ksilofon, ndërsa grupi i dytë do të këndojë dhe do ta shoqërojë me shuplaka. Puna e tyre monitorohet dhe ndihmohet.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, mënyrën e interpretimit të këngës në ksilofon.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin këngën me notat muzikore.

Reflektim për njëdhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Llojet e muzikës

Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon lloje të ndryshme të muzikës në shoqëri përmes dëgjimit muzikor.

Kontributi në rezultatet për kompetencat

kryesore të shkallës: III.4; V.8; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulës: 1.1,5; 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shprehuni përmes vallëzimit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përcjell ritmin që dëgjon.
- Vallëzon njërin nga valset e dëguara.
- Shpreh në mënyrë të thjeshtë emocionet e tij/saj gjatë vallëzimit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD-ja.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja parashtron disa pyetje për të nxitur diskutimin.

- Cilin ansambël të famshëm të muzikës rok e njihni?*
- Cilin këngëtar kosovar të muzikës zbavitëse e njihni?*
- A është ndonjëri prej jush anëtar i ndonjë grupi vallëzues?*
- Cili ansambël i këngëve e valleve vepron në qytetin tuaj?*

Mendimet e nxënësve diskutohen me klasën.



Njohuri

Shprehuni përmes vallëzimit

Muzikën e përjetojmë në mënyra të ndryshme. Proveni kësaj radhe që përjetimet t'i shprehni përmes vallëzimit.

Ja disa vallëzime:



CD 22, 23, 24



22. Johann Strauss II: Vals: Frühlingsstimmen op. 410.

23. Vallja e Tropojës.

24. The Beatles: "Rock and Roll Music".



Detyra

1. Dëgjoni dhe përcillni ritmin e muzikës, si dhe bëni dallimin mes tyre.
2. Proveni, me lëvizje, t'i përshtateni secilit lloj të muzikës, duke vallëzuar në grup apo në çifte.
3. Zgjidhni valltarin/en më të mirë të klasës.
4. Cilin ansambël të famshëm të muzikës rok e njihni?
5. Cilin këngëtar kosovar të muzikës zbavitëse e njihni?
6. A është ndonjëri prej jush anëtar i ndonjë grupi vallëzues?
7. Cili ansambël i këngëve e valleve vepron në qytetin tuaj?

Njohuri

Shprehuni përmes vallëzimit

Muzikën e përjetojmë në mënyra të ndryshme. Provoini kësaj radhe që përjetimet t'i shprehni përmes vallëzimit.

Ja disa vallëzime:



CD 22, 23, 24

- 22. Johann Strauss II: Vals: Frühlingsstimmen op. 410.
- 23. Vallja e Tropojës.
- 24. The Beatles: "Rock and Roll Music".

Detyra

1. Dëgjoni dhe përcillni ritmin e muzikës, si dhe bëni dallimin mes tyre.
2. Provoini, me lëvizje, t'i përshtateni secilit lloj të muzikës, duke vallëzuar në grup apo në çifte.
3. Zgjidhni valltarin/en më të mirë të klasës.
4. Cilin ansambël të famshëm të muzikës rok e njihni?
5. Cilin këngëtar kosovar të muzikës zbavitëse e njihni?
6. A është ndonjëri prej jush anëtar i ndonjë grupi vallëzues?
7. Cili ansambël i këngëve e valleve vepron në qytetin tuaj?

40



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Dëgjim i drejtuar

Aktiviteti 1: Dëgjojnë dhe përcjellin ritmin e muzikës, si dhe bëjnë dallimin mes tyre.

Aktiviteti 2: Provojnë, me lëvizje, t'i përshtaten secilit lloj të muzikës, duke vallëzuar në grup apo në çifte.

Aktiviteti 3: Nxënësit ndahen në grupe.

Grupi 1. Ushtron "Valsin".

Grupi 2. Ushtron "Vallen e Tropojës".

Grupi 3. Ushtron "Rock vallëzim".



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Pastaj nxënësit tregojnë emocionet e tyre gjatë vallëzimit në mënyrë të thjeshtë, duke treguar se cilin vallëzim dëshirojnë ta përsërisin në të ardhmen.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë në përcjelljen e ritmit, përshtatjen e secilit lloj të muzikës.

Detyrë:

Të mësojnë vallen e Tropojës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë muzikore
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Elementet bazike të gjuhës artistike

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Përjeton dhe dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia durmol) në këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.4; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Festojmë së bashku

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan me karakteristika datën e cila është e paraqitur në etiketën e tërhequr.
- Paraqet saktë notat në pentagram të himnit të flamurit.
- Emërton saktë të gjitha figurat me emrin festiv.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: etiketa me data të ndryshme, etiketa me ngjyra, CD-ja.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Edukim qytetar.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Diskutim i njohurive paraprake

Mësuesi/ja fillimisht paraqet përmes projektorit skemën e mëposhtme. Brenda rrethit shkruan "Festat".

Nxënësit i plotësojnë rrethët me festat që kemi gjatë vitit.

Varësisht prej kohës, disa prej tyre lexohen.




Detyra

Festojmë së bashku

Gjatë vitit, ne kemi një mori festa, duke filluar qysh në ditën e parë të shkollës, pastaj festat e fundivitit e të tjera. Secila festë ka rëndësinë e vet. Ta zëmë, ne festojmë dhe ditëlindjen e shtetit tonë, datat historike e deri te dita e fëmijëve.

- Të shohim se cilat data ju i mbani në mend. Poshtë ilustrimit, përshkruani ditën apo festën dhe rëndësinë e saj.
 - Pasi t'i keni përfunduar përshkrimet e tyre, kthejuni këngës dhe dëgjoni disa nga këngët që ju njihni dhe që keni mësuar deri më tash.
- Kush nga ju fillon?**





Detyra

Festojmë së bashku

Gjatë vitit, ne kemi një mori festa, duke filluar qysh në ditën e parë të shkollës, pastaj festat e fundivitit e të tjera. Secila festë ka rëndësinë e vet. Ta zëmë, ne festojmë dhe ditëlindjen e shtetit tonë, datat historike e deri te dita e fëmijëve.

- Të shohim se cilat data ju i mbani në mend. Poshtë ilustrimit, përshkruani ditën apo festën dhe rëndësinë e saj.
- Pasi t'i keni përfunduar përshkrimet e tyre, kthejuni këngës dhe dëgjoni disa nga këngët që ju njihni dhe që keni mësuar deri më tash.

Kush nga ju fillon?



41



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Dëgjim i drejtuar

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit ndahen në grupe.

Aktiviteti 1: Nxënësit shkruajnë të gjitha datat që mbajnë mend.

Aktiviteti 2: Mësuesja udhëzon nxënësit të hapin librin në faqen 41, ku kanë për detyrë të emërtojnë figurat me festën që i përgjigjet.

Disa nxënës lexojnë.

Aktiviteti 3: Pasi t'i kenë përfunduar përshkrimet e tyre, i kthehen këngës dhe dëgjojnë disa nga këngët që i njohin dhe që i kanë mësuar deri më tash. Nxënësit do t'i kenë etiketat me dy ngjyra, e gjelbër dhe e kuqe.

Gjatë dëgjimit të këngës nxënësit ngrehin lart ngjyrën e gjelbër nëse këngën e kanë dëgjuar më parë, kurse, nëse nuk e kanë dëgjuar, e ngrenë lart ngjyrën e kuqe.

Kështu veprohet me të gjitha këngët që dëgjohen.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit përshkruajnë në pentagram himnin e Republikës së Kosovës.

Mësuesi/ja i monitoron dhe i ndihmon ata kur kanë nevojë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për përshkrimin dhe gjetjen e sa më shumë datave të rëndësishme.

Detyrë:

Përshkruajnë në pentagram himnin e Republikës së Shqipërisë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Këngët

Rezultatet e të nxënit të temës:

Këndon dhe interpreton në instrumente.
Shoqëron këndimin me zë, me duar.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.5; III.4; III.9; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: “Pse e dua muzikën”?

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Këndon këngën duke zbatuar rregullat e këndimit.
- Shoqëron këngën me duar duke kënduar grupi.
- Imiton me lëvizje instrumentin që identifikon në këngën e dëgjuar.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD-ja, printeri, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja parashtron disa pyetje për të nxitur diskutimin.

Cili instrument të pëlqen më shumë?

Pse të pëlqen?

A di të luash në ndonjë instrument?

Cilën muzikë preferon ta dëgjosh: klasike, popullore, zbavitëse apo tjetër?

Mendimet e nxënësve diskutohen me klasën.



“Pse e dua muzikën?”

Muzika: Donika Rudi

CD 25

Gëzueshëm

A ke ën - d'rru - ar ndo - një - her' me mu - zi - kë të__ je tosh, e me te - lat

e ki - ta - rës tin - gujt t'i zbu - losh Po a - jo mu - zik' e lehtë__ që

sphi - rtin ta qet' - son me har - fën dhe fla - u - tin si kur

en - gjëjt kën - dojn'__ Shpres' të ma - dhe ke - mi__

y - je - ve t'u ngjajm'__ kën - do - ni bashk' me - ne se mu -

zi - ka ne na mban__ Kën - do - ni bashkë me ne



1. Ke vërejtur se në tekstin e këngës përmenden emrat e disa instrumenteve. Trego se për cilat instrumente bëhet fjalë.
2. Përpiqu t'i imitosh me lëvizje, duke luajtur e duke imituar, secilin nga instrumentet që përmendet në këngë.
3. Cili instrument të pëlqen më shumë dhe pse?
4. A di të luash në ndonjë instrument?
5. Cilën muzikë preferon ta dëgjosh: klasike, popullore, zbavitëse apo tjetër?



43



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Dëgjim i drejtuar

Aktiviteti 1: Nxënësit njoftohen me këngën që do ta mësojnë. Titulli **“Pse e dua muzikën”** paraqitet përmes projektorit (titulli shkruhet në tabelë në mungesë të projektorit).

Pastaj kënga e ndarë në strofa paraqitet në tabelë. Mësohet kënga strofë për strofë.

Aktiviteti 2: Lëshohet kënga në CD dhe dëgjohet me vëmendje interpretimi i këngës.

Aktiviteti 3: Njoftohen nxënësit se kënga këndohet sipas rregullave: Një nxënës këndon këngën, kurse nxënësit e tjerë e shoqërojnë me duar.

Nxënësit individualisht dhe në grup këndojnë këngën e mësuar, duke e shoqëruar me zë dhe me duar.



Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit

Te kjo pjesë e orës mësimore, nxënësit kanë për detyrë që të gjejnë se cilat instrumente

përmenden në tekst. Pasi t’i gjejnë, detyrë e tyre është që t’i imitojnë me lëvizje, duke luajtur e duke imituar, secilin nga instrumentet që përmendet në këngë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, mënyrën e interpretimit të këngës.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin këngën me notat muzikore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Instrumentet muzikore

Rezultatet e të nxënimit të temës:

Dallon instrumentet për nga materiali ndërtues, burimi tingullor (instrumente të drunjtja, të tunxhit, frymore, me harqe etj.), mënyra e interpretimit, ansambleve që u përkasin etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.5; III.4; V.8; VI.2,3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Violina - Klarineta

Rezultatet e të nxënimit të orës mësimore:

- Përcakton saktë familjen e instrumenteve, violinës dhe klarinetës.
- Plotëson dallimet dhe të përbashkëtat e klarinetës dhe violinës në skemën e përgatitur.
- Komenton thjesht njëren nga poezitë e Agim Devës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fotografi, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja paraqet në projektor dy fotografi. Detyrë e nxënësve është që t'i analizojnë.

Parashtron disa pyetje për të nxitur diskutimin:

Çfarë po shihni në fotografi?

Cilat instrumente muzikore janë?

Në cilën familje të instrumenteve muzikore bëjnë pjesë?

Mendimet e nxënësve diskutohen me klasën.



Njohuri

Violina

Violina bën pjesë në familjen e instrumenteve me harqe. Ajo ka katër tela të lartësive të ndryshme. Tingulli në violinë fitohet përmes rrëshqitjes së harkut mbi tela. Nga të gjitha instrumentet e tjera, violina e ka rolin më të rëndësishëm në përbërje të orkestrës simfonike.



Rrëshqet harku mbi violinë,
Mbi katër tela që gurgullijnë.

Që gurgullijnë në krahun tim,
si një vogëlushe në përmallim.

Harku rrëshqet - kënga buzëqesh
Vallë, violina s'është mbretëreshë?

(Agim Deva)

Klarineta

Klarineta është instrument frymor me një diapazon të gjerë. Ajo bën pjesë në orkestra të muzikës klasike, por atë e gjejmë edhe në orkestrinat popullore.

Vallë, klarinetën kush e kupton,
Me frymën time tinguj krijon.

Ua prekë pullat që përmes tonesh-
T'ushtojë si lumi midis kanionesh.

Midis valltarëve shtatgjatë na hedhet -
Shpresojmë një ditë MISS do të zgjedhet.

(Agim Deva)



CD 26, 27, 28

26. **Rafet Rudi** *Song of Tana* (Kënga e Tanës), për klarinetë e piano.

27. **Wolfgang Amadeus Mozart:** *Clarinet Concerto in A major, K.62.*

28. **Valton Beqiri:** Vallja për violinë e piano.



Njohuri

Violina

Violina bën pjesë në familjen e instrumenteve me harqe. Ajo ka katër tela të lartësive të ndryshme. Tingulli në violinë fitohet përmes rrëshqitjes së harkut mbi tela. Nga të gjitha instrumentet e tjera, violina e ka rolin më të rëndësishëm në përbërje të orkestrës simfonike.



Rrëshqet harku mbi violinë,
Mbi katër tela që gurgullijnë.

Që gurgullijnë në krahun tim,
si një vogëlushe në përmallim.

Harku rrëshqet - kënga buzëqesh
Vallë, violina s'është mbretëreshë?

(Agim Deva)

Klarineta

Klarineta është instrument frymor me një diapazon të gjerë. Ajo bën pjesë në orkestra të muzikës klasike, por atë e gjejmë edhe në orkestrinat popullore.



Vallë, klarinetën kush e kupton,
Me frymën time tinguj krijon.

Ua prekë pullat që përmes tonesh-
T'ushtojë si lumi midis kanionesh.

Midis valltarëve shtatgjatë na hedhet -
Shpresojmë një ditë MISS do të zgjedhet.

(Agim Deva)

CD 26, 27, 28

26. **Rafet Rudi** *Song of Tana* (Kënga e Tanës), për klarinetë e piano.

27. **Wolfgang Amadeus Mozart**: *Clarinet Concerto in A major, K.62*.

28. **Valton Beqiri**: Vallja për violinë e piano.

44



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

*Mendo - puno - thua*ja grupit

Aktiviteti 1: Nxënësit mësojnë se violina bën pjesë në familjen e instrumenteve me harqe. Ajo ka katër tela të lartësive të ndryshme. Tingulli në violinë fitohet përmes rrëshqitjes së harkut mbi tela. Nga të gjitha instrumentet e tjera, violina e ka rolin më të rëndësishëm në përbërje të orkestrës simfonike.

Aktiviteti 2: Klarineta është instrument frymor me një diapazon të gjerë. Ajo bën pjesë në orkestra të muzikës klasike, por atë e gjejmë edhe në orkestrinat popullore.

Aktiviteti 3: Secilit nxënës, në mënyrë individuale, i shpërndahet ushtrimi i përgatitur nga vetë mësuesi/ja. Detyrë e nxënësve është që të zgjedhin njërën nga poezitë e Agim Devës dhe ta shkruajnë në pjesën e parë të ushtrimit. Në pjesën e dytë të ushtrimit, nxënësit kanë për detyrë që të komentojnë pjesën e lexuar. Varësisht prej kohës, disa prej tyre lexohen.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit ndahen në grupe. Nxënësit në grupe kanë për detyrë që të gjejnë dallimet dhe të përbashkëtat e dy instrumenteve muzikore. Mësuesi/ja i monitoron dhe i ndihmon kur kanë nevojë. Prezantohet puna e nxënësve.


Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, mënyrën e interpretimit të poezisë dhe krahasimin e instrumenteve muzikore.

Detyrë:

Mësojnë njërën poezi të Agim Devës.

Violina Të përbashkëtat Klarineta



Reflektim për rrezultatin e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Krijimet muzikore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Improvizon në ritme të ndryshme me zë dhe instrumente ritmike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.1; III.4; III.9; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrim ritmik me nota katërshe dhe tetëshe

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përcjell me duartrokitje ose instrument muzikor melodinë në bazë të notave.
- Paraqet saktë notat katërshe dhe tetëshe në pentagram sipas udhëzimeve në tekst.
- Plotëson Diagramin e Venit duke veçuar të përbashkëtat dhe dallimet mes notës katërshe dhe asaj tetëshe.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, ndonjë instrument ritmik.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Diskutim i njohurive paraprake


Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja parashtron një pyetje. Çka dini për notën katërshe dhe tetëshe?

Nxënësit në dyshe mendojnë përgjigjen. Mendimet e tyre diskutohen me klasën.



Detyra

Ushtrim ritmik me nota katërshe dhe tetëshe




Luajmë

Ushtrimet ritmike mund t'i ekzekutoni në ndonjë instrument (dajre, triangël, shkopinj) ose me duartrokitje.



Detyra

Ushtrim ritmik me nota katërshe dhe tetëshe



Luajmë

Ushtrimet ritmike mund t'i ekzekutoni në ndonjë instrument (dajre, triangël, shkopinj) ose me duartrokitje.

45



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Vëzhgo - Mendo - Interpreto

Në këtë pjesë të orës mësimore hapet libri. Nxënësit mësojnë se muzika është arti i shprehjes së ndjenjave dhe i mendimeve me anë të tingujve. Elementet kryesore të muzikës janë toni (ku përfshihet: melodia dhe harmonia), ritmi (bashkë me konceptet e afërta që janë tempa, metri dhe artikulimi), dinamika, si dhe kualiteti zanor.

Aktiviteti 1: Ushtrimet ritmike të faqes 43 mundohen t'i ekzekutojnë në ndonjë instrument ose me duartrokitje.

Kjo përsëritet disa herë derisa nxënësit e përvetësojnë mirë.

Aktiviteti 2: Ushtrimin e faqes 43 e përshkruajnë në fletoren e pentagramit.


Mësuesi/ja i monitoron dhe i ndihmon nxënësit kur kanë nevojë.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit

Nota katërshe Të përbashkëtat Nota tetëshe



Te kjo pjesë e orës mësimore, nxënësit ndahen në grupe.

Në grupe kanë për detyrë që të gjejnë dallimet dhe të

përbashkëtat e notës katërshe dhe notës tetëshe.

Puna e tyre monitorohet dhe ndihmohet. Prezantohet puna e nxënësve.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, mënyrën e interpretimit të këngës.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin këngën me notat muzikore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Këngët

Rezultatet e të nxënit të temës:

Këndon dhe interpreton në instrumente.
Shoqëron këndimin me zë, me duar.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.3; II.5; III.4; III.9; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: “Urime Kosovë”

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Këndon këngën duke zbatuar rregullat e këndimit.
- Shoqëron këngën me duar duke kënduar grupi.
- Përshkruan me së paku tri cilësi që ka shteti i Kosovës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD-ja, printeri, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja parashtron disa pyetje për të nxitur diskutimin.

Kur u shpall pavarësia e Kosovës?

Cili është flamuri ynë shtetëror?

Kush e nënshkroi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës?

Mendimet e nxënësve diskutohen me klasën.

“Urime Kosovë” CD 31

Muzika: Nazmi Aliu
Teksti: Xhevrije Namani

Shum' u - ri me o më - më - dhe ven - di i shqj - po - nja - ve

të kam zan' e t'kam at - dhe të kam zan' e t'kam at - dhe

U - ri - me Ko - so - va i - me me k'to y - je që shkël-qen'

shum' u - ri - me o at - dhe më ke bij' e t'kam fo - le

Shumë urime o vendi im **Ref.** Urime Kosova ime
Që shkëlqen si yll në qiell me k'to yje që shkëlqen
Do të ruaj si syt' e mi Shum' urime o atdhe
Do këndoj me dashuri Më ke bij' e t'kam atdhe

48



Detyra

1. Shprehni ndjenjat dhe emocionet duke interpretuar këngën.
2. Duke kënduar, krijoni lëvizje trupore për ta shoqëruar këngën.



Si do ta përshkruaje vendin tënd?

49



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Dëgjim i drejtuar

Aktiviteti 1: Nxënësit njoftohen me këngën që do ta mësojnë. Titulli “**Urime Kosovë**” paraqitet përmes projektorit (titulli shkruhet në tabelë në mungesë të projektorit).

Pastaj kënga e ndarë në strofa paraqitet në tabelë. Mësohet kënga strofë për strofë.

Aktiviteti 2: Lëshohet kënga në CD dhe dëgjohet me vëmendje interpretimi i këngës.

Aktiviteti 3: Njoftohen nxënësit se kënga këndohet sipas rregullave: Një nxënës këndon këngën, kurse nxënësit e tjerë e shoqërojnë me duar. Nxënësit individualisht dhe në grup këndojnë këngën e mësuar, duke e shoqëruar me zë dhe me duar.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënës

Te kjo pjesë e orës mësimore, mësuesi/ja parashtron një pyetje.

Si do ta përshkruaje vendin tënd?

Nxënësit në mënyrë individuale shprehin

mendimet e tyre. Mësuesi/ja i monitoron dhe i ndihmon ata që kanë nevojë. Disa prej tyre lexohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, mënyrën e interpretimit të këngës.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin këngën me notat muzikore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Këngët

Rezultatet e të nxënit të temës:

Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe).
Shoqëron këndimin me zë, me duar.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.3.4; V.8; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: “Lumenjtë e vendit tim”,
“Për mëmëdhenë”

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Mëson këngën sipas rregullave duke e dëgjuar.
- Shqipton qartë rrokjet dhe fjalët gjatë këndimit me zë.
- Shoqëron me duar këngën që këndohet nga grupi.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fotografi me lumenjtë e Kosovës, projektori, laptopi, CD-ja.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim i njohurive paraprake

Te kjo pjesë e orës mësimore, mësuesi/ja i ndan nxënësit në grupe.

Në secilin grup shpërndan fotografitë me lumenjtë e Kosovës dhe emrat e tyre.

Nxënësit në grupe kanë për detyrë të krijojnë dyshe, duke përshtatur emrin me fotografinë që i takon.

Prezantohet puna e secilit grup.

Grupi më i shpejtë dhe më i saktë shpallet fitues.

“Lumenjtë e vendit tim”

Muzika: Rafet Rudi
Teksti: Agim Deva

Rrjedh një Val - bo - në, një Vjo - së një Shkum - bim Rrjedh ky E - re -
E kjo Kre - na jo - në, e lum - bër - dhi plak Va - lë val' Ko -
ni - ku rrjedh ky lu - mi Drin Sot jam më i pa - sur
so - vës son' i ja - pin shumë gjak
se ndoj her' më par' de - tin ma dhu - ru - an kt'a lu - menjt' ko - so - var'

Detyra

1. Përkrahuraj bukuritë e vendit tënd.
2. Çfarë male ka Kosova?
3. Trego për lumenjtë e qyteteve që ka Kosova.
4. Trego për përshtypjet e tua për vendet që ke vizituar.

28

"Për mëmëdhenë"

CD 11

Muzika: Mihal Grameno
Teksti: Mihal Grameno



- Secilin tingull dhe rrokje, gjatë këndimit të këngës, shqiptojeni qartë.
- Përpiquni të keni një ton të rrumbullakuar, të lirë e të bukur dhe të shprehni krenari, forcë, guxim dhe vendosmëri.
- Rretho. Cila mënyrë e këndimit i përshtatet më së miri këngës?

- a) gazmore;
- b) solemne;
- c) mallëngjyese.

29



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Dëgjim i drejtuar

Aktiviteti 1: Nxënësit njoftohen me këngën që do ta mësojnë. Titulli "Lumenjtë e vendit tim", "Për mëmëdhenë" paraqitet përmes projektorit (titulli shkruhet në tabelë në mungesë të projektorit). Pastaj kënga e ndarë në strofa paraqitet në tabelë. Mësohet kënga strofë për strofë.

Aktiviteti 2: Lëshohet kënga në CD dhe dëgjohet me vëmendje interpretimi i këngës.

Aktiviteti 3: Njoftohen nxënësit se kënga këndohet sipas rregullave: Një nxënës këndon këngën, kurse nxënësit e tjerë e shoqërojnë me duar.

Nxënësit individualisht dhe në grup këndojnë këngën e mësuar, duke e shoqëruar me zë dhe me duar.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që secilin tingull dhe rrokje, gjatë këndimit të këngës, ta shqiptojnë qartë; të përpiqen

të kenë një ton të rrumbullakuar, të lirë e të bukur dhe të shprehin krenari, forcë, guxim dhe vendosmëri.

Nxënësit në dyshe gjejnë se cila mënyrë e këndimit i përshtatet më së miri këngës.

Mendimet e nxënësve diskutohen me klasën.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për mënyrën dhe saktësinë e interpretimit të këngës dhe zbatimin e rregullave gjatë këndimit.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin këngën me notat muzikore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë muzikore
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Elementet bazike të gjuhës artistike

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Njeh notacionin grafik për disa nga vetitë themelore të tingullit muzikor.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.4,7; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Plotëso katrorët e zbrazët dhe zbulo!


- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Bashkon rrokjet për të formuar fjalë me kuptim.
 - Zbulon notën muzikore në fjalët e formuara.
 - Shkruan të gjitha notat në pentagram sipas rregullave.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.


Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: etiketat me rrokje, pentagrami.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

 **Parashikimi:**
Përgatitja për të nxënë
Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja parashtron disa pyetje për të nxitur diskutimin.
Si quhet shtëpia e notave?
Prej sa notave përbëhet vargu i tingujve?
Si quhet vargu i notave?
 Nxënësit në dyshe mendojnë përgjigjen.
 Mendimet e nxënësve diskutohen me klasën.





KRA



ISTE



TO



Detyra

Shëno përgjigjet:

- | | |
|---------|---------|
| 1 _____ | 4 _____ |
| 2 _____ | 5 _____ |
| 3 _____ | 6 _____ |

51



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

*Mendo - puno - thua*ja grupit

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit ndahen në grupe.

Aktiviteti 1: Në secilin grup shpërndahen fjalë të ndara në rrokje.

Detyrë e nxënësve është që duke bashkuar rrokjet të formojnë fjalë me kuptim.

Aktiviteti 2: Nxënësit zbulojnë se cila rrokje cilën notë muzikore paraqet.

Puna e nxënësve prezantohet.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit shkruajnë notat muzikore në pentagram.

Mësuesi/ja i monitoron dhe i ndihmon kur kanë nevojë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e gjetjes së përgjigjeve dhe zbulimit të notave muzikore në çdo fjalë.

Detyrë:

Në pentagram paraqesin notat muzikore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Këngët

Rezultatet e të nxënit të temës:

Këndon dhe interpreton në instrumente.
Shoqëron këndimin me zë, me duar.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.5; III.4,9; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Këngët tona popullore

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Këndon këngën duke zbatuar rregullat e këndimit.
- Shoqëron këngën me duar duke kënduar grupi.
- Paraqet bukur këngën në pentagram.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD-ja, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim i njohurive paraprake

Mësuesi/ja fillimisht paraqet përmes projektorit skemën e mëposhtme. Brenda rrethit shkruan titullin “Këngët popullore”. Mendimet e nxënësve shkruhen në secilin drejtkëndësh.

Varësisht prej kohës, disa prej tyre lexohen.



Njohuri


Këngët tona popullore

Muzika jonë është e vjetër dhe ajo këndohet, ruhet dhe trashëgohet nga brezi në brez, ndonëse autorët e këngëve janë të panjohur. Këto këngë, populli zakonisht i këndon në festa dhe në ahengje familjare dhe, përmes tyre, shpreh ndjenja dhe emocione të ndryshme, si: *gëzimin, lumturinë, dashurinë* etj. Ato flasin, gjithashtu, për natyrën e saj të pasur, për datat dhe ngjarjet e rëndësishme historike, për heronjtë etj.

“Këngë labe”

CD 32

Shpejtë



Luli-lul, xhepin me sanë-oj,
rrejtma, zot, me babë me nanë-oj.
Luli-lul, xhepin me mollë-hoj,
rrejtma, zot, me vëllazën, me motra-oj.
Luli-lul, xhepin me kashtë-oj,
rrejtma, zot, me bab'gjysh, me dajë-oj.

Njohuri

"Mori lulja e blinit"

CD 34



- Mori, lulja blinit
Moj vajza Ulqinit
A ma ke, moj, babën?
- Mos me pas' un babën
Kush ma ban mu arkën.

- Mori, lulja blinit
Moj vajza Ulqinit
A ma ke ti nanën?
- Mos me pas' un nanën
Kush ma bën mu pajën.

CD 33, 34

33. "Hajde dalim nga pazari" - Nexhmije Pagarusha.
34. "Moj lulja e blinit" - Fatmira Breçani.

1. Cila këngë ju pëlqeu më shumë?
2. Proveni ta këndonit atë me mësuesin/en.
3. Pyetni të moshuarit për këngët e vjetra popullore. Proveni t'i mësoni dhe disa nga to edhe t'i këndonit në klasë.

53



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Dëgjim i drejtuar

Aktiviteti 1: Nxënësit njoftohen me këngën që do të mësojnë. Titujt "Këngë labe" dhe "Moj lulja e blinit" paraqiten përmes projektorit (titujt shkruhen në tabelë në mungesë të projektorit). Pastaj këngët e ndara në strofa paraqiten në tabelë. Mësohen këngët strofë për strofë.

Aktiviteti 2: Lëshohen këngët dhe dëgjohe me vëmendje interpretimi i tyre.

Aktiviteti 3: Njoftohen nxënësit se këngët këndohen sipas rregullave: Një grup këndon këngën, kurse nxënësit e tjerë e shoqërojnë me duar. Nxënësit në grupe këndojnë këngën e mësuar, duke i shoqëruar me zë dhe me duar.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit shkruajnë në pentagram një rën prej dy këngëve që kanë dëgjuar.

Mësuesi/ja i monitoron dhe i ndihmon kur kanë nevojë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, mënyrën e interpretimit të këngëve.

Detyrë:

Të pyesin të moshuarit për këngët e vjetra popullore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë muzikore
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Instrumentet muzikore

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Dallon ngjyrën tingullore të instrumenteve muzikore (popullore dhe klasike) përmes dëgjimit të veprave muzikore të përshtatshme për moshën e tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.4; V.8; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: “Karnavali i kafshëve”

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përmbledh rrjedhshëm karakteristikat kryesore të aktivitetit të caktuar.
- Imiton me lëvizje trupore veprën që dëgjon.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD-ja, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
Diskutim i njohurive paraprake

Mësuesi/ja fillimisht shfaq për disa minuta në videoprojektor videon me veprën “Mjellma” të Camille Saint-Saënsit.

(<https://www.youtube.com/watch?v=LDUKcv2wEy0>).

Nga nxënësit kërkohet që ta vështrojnë me kujdes videon e paraqitur.



“Karnavali i kafshëve”

CD 35

35. Camille Saint-Saëns: “Karnavali i kafshëve”.

Njohuri

Në veprën “Karnavali i kafshëve”, kompozitori Camille Saint-Saënsi, përmes muzikës, përshkruan kafshët e ndryshme, si: pulën, breshkën, elefantin, kangurin etj. Veprat muzikore mund të jenë të ndryshme: për orkestër ose për instrumente specifike. Vepra “Mjellma” nga Camille Saint-Saënsi ka shumë variante. Një nga to është përshtatur për instrumentin e violonçelit.

Camille Saint-Saënsi ishte kompozitor, pianist e dirigjent francez. Nga kompozitorët e mëdhenj botërorë u cilësua si gjeni, pasi për herë të parë kishte koncertuar qysh në moshën 10-vjeçare.



Detyra

1. Dëgjoni me vëmendje veprën dhe shprehni emocionet.
2. Imitoni përmes lëvizjeve trupore.

55



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive: Përpunimi i përmbajtjes *Lexim i drejtuar*

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit ndahen në 4 grupe dhe udhëzohen të hapin librin. Grupi i parë e lexon aktivitetin e parë, grupi i dytë aktivitetin e dytë, grupi i tretë aktivitetin e tretë dhe grupi i katërt aktivitetin e katërt. Secili grup prezanton punën e grupit, kurse mësuesi/ja ndihmon dhe plotëson grupin me njohuritë e reja.

Aktiviteti 1: Nxënësit mësojnë se në veprën “Karnavali i kafshëve”, kompozitori Camille Saint-Saënsi, përmes muzikës, përshkruan kafshët e ndryshme, si: pulën, breshkën, elefantin, kangurin etj.

Aktiviteti 2: Nxënësit mësojnë se veprat muzikore mund të jenë të ndryshme: për orkestër ose për instrumente specifike.

Aktiviteti 3: Nxënësit mësojnë se vepra “Mjellma” nga Camille Saint-Saënsi ka shumë variante. Një nga to është përshtatur për instrumentin e violonçelit.

Aktiviteti 4: Nxënësit mësojnë se Camille Saint-

Saënsi ishte kompozitor, pianist e dirigjent francez. Nga kompozitorët e mëdhenj botërorë u cilësua si gjeni, pasi për herë të parë kishte koncertuar qysh në moshën 10-vjeçare.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit dëgjojnë me vëmendje veprën dhe shprehin emocionet e tyre. Imitojnë përmes lëvizjeve të tyre trupore.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për përmbledhjen e aktivitetit, mënyrën e imitimit përmes lëvizjeve të tyre trupore.

Detyrë:

Shikojnë dhe analizojnë ndonjë koncert të “Karnavalit të kafshëve”.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Këngët

Rezultatet e të nxënit të temës:

Këndon dhe interpreton në instrumente.
Shoqëron këndimin me zë, me duar.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.5; III.4; III.9; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: “Lulet e marsit” - Kompozitorë të njohur të muzikës për fëmijë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Këndon këngën duke zbatuar rregullat e këndimit.
- Shoqëron këngën me duar duke kënduar grupi.
- Jep së paku një përgjigje në pyetjen e parashtruar.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD-ja, printeri, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja parashtron disa pyetje për të nxitur diskutimin.

Cilat janë ngjyrat e pranverës?

Kur fillon stina e pranverës?

Çfarë pamje ka natyra?

Çfarë bën bujku?

Cilat janë këngët që dini për pranverën?

Cilat janë rregullat e këndimit?

Mendimet e nxënësve diskutohen me klasën.

"Lulet e marsit" CD 36

Muzika: Pranvera Badivuku

Allegretto

Ca të ver - dha ca të ku - qe qa-fë gjat-ta bu-zë bur - bu - qe

tu-fa tu-fa lu - lë-zoj - në - an' e mba-në kun-dër moj - në

vi-në go-cat bëjn' ku-ro - rë

çë-lin lu-let, ska më bo - rë A - gu - li - çe, ma - nu - sha - qe

plot zym-by - la, lu-le ta-qe plot zym-by-la lu-le ta - qe një nga një, ha-pin flet'

kur sheh lu - len e bëjn' ver' kur sheh lu - len e bëjn' ver'

Fjalorthi

Agulçe - bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të hollë, me gjethe vezake e lule të verdha, që rritet në livadhe dhe që çel në fillim të pranverës.

56


Njohuri

Kompozitorë të njohur të muzikës për fëmijë

Muzikën për fëmijë ne e dëgjojmë në radio, në televizion, në festivale të ndryshme që organizohen në qytetet e Kosovës etj. Kompozitorët tanë gjithmonë kujdesen që këngët të jenë sa më të bukura. Gjithashtu, në librat tuaj të muzikës ju keni mësuar këngë të ndryshme - këngë që kompozitorët tanë i kanë krijuar për ju. Ndër emrat e njohur të muzikës për fëmijë në Kosovë dallohen kompozitorët: *Pranvera Badivuku, Gazmend Zajmi, Musa Piperku, Reshat Randobrava, Xhevdet Gashi, Naim Krasniqi* etj.



Pranvera Badivuku




Musa Piperku



Reshat Randobrava



Gazmend Zajmi



Xhevdet Gashi



Naim Krasniqi

57



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes *Dëgjim i drejtuar*

Aktiviteti 1: Nxënësit njoftohen me këngën që do ta mësojnë. Titulli “**Lulet e marsit**” paraqitet përmes projektorit (titulli shkruhet në tabelë në mungesë të projektorit).

Pastaj kënga e ndarë në strofa paraqitet në tabelë. Mësohet kënga strofë për strofë.

Aktiviteti 2: Lëshohet kënga në CD dhe dëgjohet me vëmendje interpretimi i këngës.

Aktiviteti 3: Njoftohen nxënësit se kënga këndohet sipas rregullave: Një nxënës këndon këngën, kurse nxënësit e tjerë e shoqërojnë me duar. Nxënësit individualisht dhe në grup këndojnë këngën e mësuar, duke e shoqëruar me zë dhe me duar.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënësve

Te kjo pjesë e orës mësimore, mësuesi/ja parashtron një pyetje.

Ndër emrat e njohur të muzikës për fëmijë në Kosovë, cilët kompozitorë dallohen?

Nxënësit në grupe gjejnë përgjigjen e pyetjes së dhënë. Mendimet e tyre diskutohen me klasën. Puna e tyre monitorohet dhe ndihmohet.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, mënyrën e interpretimit të këngës.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin këngën me notat muzikore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Krijimet muzikore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Ritmizon në mënyrë kreative vargjet, poezitë, gjëgjëzat etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.4; III.4; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Dinamika

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Zbulon së paku emrin e një gjëgjëze.
- Vizaton katrorët e mëdhenj dhe të vegjël sipas ritmit të rrokjeve.
- Shoqëron rrokjet me shtagëza apo duartrokitje.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, shtagëza, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja parashtron disa pyetje për të nxitur diskutimin.

Çfarë janë gjëgjëzat?

Kush i ka krijuar?

A dini ndonjë gjëgjëzë?

Mendimet e nxënësve diskutohen me klasën.





Njohuri

Dinamika

Topat e borës do t'ju ndihmojnë që këngën ta këndonit me dinamikë. Kur topi i borës është me ngjyrë më të çelët, do ta këndonit këngën me zë të ulët e lehtë, ndërsa, kur topi i borës është me ngjyrë më të errët, do ta këndonit me zë më të lartë e më fort. Këtë ushtrim mund ta bëni edhe në rolin e dirigjentit, duke udhëhequr korin e klasës dhe dinamikën.



58



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Dëgjim i drejtuar

Aktiviteti 1: Nxënësit ndahen në dyshe. Në secilën dyshe, mësuesi/ja shpërndan gjëgjëzat e përgatitura nga vetë ai/ajo. Detyrë e nxënësve është që të gjejnë se për kë bëhet fjalë. Grupi që zbulon gjëgjëzat shpallet fitues.

Aktiviteti 2: Vizatojnë rrokje të gjata me katrorët e mëdhenj dhe rrokje të shkurtra me katrorët e vegjël.

Aktiviteti 3: Përvetësojnë mirë dhe pa gabime dy gjëgjëzat e paraqitura në libër.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënët

Në këtë pjesë të orës mësimore, pasi ta kenë përvetësuar mirë dhe pa gabime, provojnë që rrokjet t'i shoqërojnë me shtagëza ose duartrokitje.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, mënyrën e interpretimit të gjëgjëzave dhe gjetjen e tyre.

Detyrë:

Shkruajnë nga dy gjëgjëza secili prej tyre.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**Fusha kurrikulare:** Artet**Lënda:** Edukatë muzikore**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III**Tema:** Ngjarjet artistike**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetanake dhe të të tjerëve me fjalor e terma adekuatë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.4,5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**Njësia mësimore:** Vlerësim i njohurive**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Ndjek udhëzimet për plotësimin e vlerësimit.
- Plotëson duke iu përgjigjur saktë pyetjeve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: vlerësimi i njohurive.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS**Parashikimi:****Përgatitja për të nxënë***Diskutim i njohurive paraprake*

Në këtë veprimtari, mësuesi/ja njofton nxënësit lidhur me vlerësimin. Njoftohen nxënësit për numrin e pyetjeve, kohën sa do të zgjasë si dhe pikët.

Bashkëbisedim me nxënësit.

Vlerësim i njohurive

Një instrument frymor: _____.

Nota në zbrazetirën e dytë: _____.

Nota gjysmë ka _____ tetëshe.

Pentagrami përbëhet prej _____ vijave dhe _____ hapësirave.

Një instrument në të cilin ekzekutohet me hark: _____.

Para se t'i shënojmë notat në pentagram, e shënojmë shenjën e cila quhet: _____.

Vlerësim i njohurive

Një instrument frymor: _____.

Nota në zbrazëtirën e dytë: _____.

Nota gjysmë ka _____ tetëshe.

Pentagrami përbëhet prej _____ vijave dhe _____ hapësirave.

Një instrument në të cilin ekzekutohet me hark: _____.

Para se t'i shënojmë notat në pentagram, e shënojmë shenjën e cila quhet: _____.

59



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Dëgjim i drejtuar

Në këtë veprimtari, mësuesi/ja i shpërndan testin secilit nxënës në mënyrë individuale.

Nxënësit duhet të punojnë në mënyrë të pavarur.

Duhet respektuar koha dhe nuk duhet penguar njëri-tjetrin.

Pas plotësimit, secili nxënës e dorëzon fletën të mësuesi/ja.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënësve

Në këtë veprimtari, mësuesi/ja së bashku me nxënësit bëjnë analizën e pyetjeve.

Parashtron pyetjet dhe kërkon nga nxënësit që të gjejnë përgjigjet e tyre. Diskutohen mendimet e tyre. Puna e tyre monitorohet.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për respektimin e kohës, dhënien e përgjigjeve.

Detyrë:

Përshkruajnë përgjigjet në fletore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë muzikore
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Elementet bazike të gjuhës artistike

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Identifikon llojet e institucioneve artistike (galeri, teatër, muze, sallë koncertale etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.1; III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: T'i njohim institucionet kulturore

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Vendos saktë në kolonat përkatëse fotografitë dhe emrat e institucioneve.
- Përgjigjet saktë në njërën nga pyetjet e parashtruara.
- Krijon teatrin e kukullave sipas hapave që sheh përmes projektorit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, fotografi me institucione, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja parashtron disa pyetje për të nxitur diskutimin.

- Cilat janë institucionet kulturore?
 A dini ju ndonjë institucion kulturor?
 A keni vizituar ndonjë institucion kulturor?*

Mendimet e nxënësve diskutohen me klasën.



Njohuri

T'i njohim institucionet kulturore


Plotësoni hapësirat aty ku mungojnë fjalët:

Teatri

Në teatër mund të shohim një shfaqje të cilën aktorët e performojnë para nesh. Aty aktorët luajnë _____ e tyre.



1. A keni qenë ndonjëherë në teatër?
2. Cila është shfaqja që keni parë?



Teatri i kukullave

Teatri i kukullave është një lloj teatri ku përdoren edhe kukullat dhe loja me to. Ndonjëherë kanë zë të regjistruar e ndonjëherë ai realizohet nga njerëzit.



1. A e dini se pse quhet Teatri i kukullave?
2. A keni parë ndonjë shfaqje në Teatrin e kukullave?






Salla e teatrit të operës

Kështu duket një sallë e teatrit të operës.



1. Po ju, e dini se ç'është salla e teatrit të operës dhe pse quhet kështu?



Kinemaja

Kjo është kinemaja, vendi ku bashkë do të shohim _____ e ardhshëm. Mos harroni që muzika është pjesë shumë e rëndësishme e një filmi.



1. Cili është filmi juaj më i pëlqyer?



Salla koncertale

Ndërsa kjo është salla koncertale, ku mund të _____ koncerte të ndryshme të muzikës klasike.

Bashkë do të përcjellim ndonjë koncert dhe, pastaj, do të flasim për përshypjet tuaja.



Galeria e arteve

Dhe për fund, kjo është galeria ku mund të shohim ekspozitat me piktura, fotografitë apo skulpturat më të bukura.

Të vizitojmë bashkë ndonjë ekspozitë dhe të diskutojmë më pas.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Dëgjim i drejtuar

Nxënësit ndahen në grupe.

Në secilin grup mësuesi/ja shpërndan ushtrimin e përgatitur.

Aktiviteti 1: Detyrë e nxënësve është që në kolonën e parë të vendosin fotografitë e institucioneve, kurse në kolonën e dytë të gjejnë emrin që i takon.

Aktiviteti 2: Detyrë e nxënësve është që në kolonën e dytë të gjejnë përgjigjet e pyetjeve që ndodhen në kolonën e parë.

A keni qenë ndonjëherë në teatër?

Cila është shfaqja që keni parë?

A e dini se pse quhet "Teatri i Kukullave"?

A keni parë ndonjë shfaqje në "Teatrin e Kukullave"?

Puna e nxënësve prezantohet.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënësve

Mësuesi/ja fillimisht shfaq për disa minuta në videoprojektor videon me përrallën me fluturat. (<https://www.youtube.com/watch?v=X4QaKvZqzX4>). Nga nxënësit kërkohet që ta vështronjë me kujdes videon e paraqitur. Nxënësit në grupe, duke ndjekur hapat në videon e paraqitur në projektor, punojnë teatrin e kukullave. Puna monitorohet dhe ndihmohet. Pas mbarimit të punës, krijimet ekspozohen në grupe.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, mënyrën e punimit të teatrit të kukullave me mjete ricikluese.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin këngën me notat muzikore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Krijuesit dhe performuesit

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon ndonjë figurë markante nga krijuesit dhe performuesit artistikë botërorë dhe vendorë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.1; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Profesionet muzikore: Kompozitori, dirigjenti, interpretuesit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Liston dallimet dhe të përbashkëtat e kompozitorit, dirigjentit dhe interpretuesit.
- Përgjigjet saktë në pyetjet e parashtruara.
- Imiton dirigjentin në bazë të muzikës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD-ja, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja parashtron disa pyetje për të nxitur diskutimin.

Trego emrin e ndonjë kompozitori nga Shqipëria apo nga Kosova.

A njihni ndonjë kompozitor të njohur botëror?

A njihni ndonjë interpretues kosovar?

Veço ndonjë këngëtar apo instrumentist të njohur botëror apo të vendit.

Mendimet e nxënësve diskutohen me klasën.



Njohuri

Profesionet muzikore

Kompozitori/ja

Kompozitori/ja krijon muzikën që ju e këndon, e luani apo e dëgjoni. Ai/ajo komponon muzikë të llojeve dhe formave të ndryshme, të cilat interpretohen nga ansamblet, si: kori, orkestra, nga solistë të ndryshëm e formacione të tjera instrumentale dhe vokale.



Dirigjenti/ja

Dirigjenti/ja drejton (udhëheq) orkestrën apo korin. Ai/ajo i udhëzon instrumentistët dhe këngëtarët që të luajnë saktë dhe t'i shprehin të gjitha idetë e kompozitorit. Përmes lëvizjes së duarve apo të shkopit, ai/ajo arrin që orkestra apo kori të realizojë veprën muzikore me saktësi të madhe. Zakonisht dirigjenti/ja i orkestrës përdor shkopin për dirigjim.



1. Trego emrin e ndonjë kompozitori a kompozitoreje nga Kosova apo Shqipëria.
2. Po ndonjë kompozitor të njohur botëror, njeh ti?
3. Imito dirigjentin në bazë të muzikës së dëgjuar.

Interpretuesit

Interpretuesit janë artistë që realizojnë veprat muzikore. Ata luajnë në instrumente të ndryshme apo këndojnë.
T'i njohim disa prej tyre:



CD 37, 38, 39



37. *Le Fandango Varié_ op. 16 (Dioniso Aguado) (fragment) - Petrit Çeku.*
38. *Lucie Horsch - blokflaut - Vivaldi.*
39. *"Për ty atdhe" (fragment) - Ramë Lahaj dhe kori Siparantum.*



Detyra

1. Dëgjo me vëmendje nga CD-ja dhe bëj dallimin në mes instrumenteve që po dëgjoni.
2. Demonstrato dhe përshkruaj se në ç'mënyrë këta interpretetë luajnë në instrumentet e tyre.



1. A njihni ndonjë interpret kosovar?
2. Veçojë ndonjë këngëtar apo instrumentist të njohur botëror apo të vendit.
3. A ke përcjellë ndonjë koncert solistik, të korit apo orkestrës?
4. Përshkruaj emocionet që ke përjetuar gjatë një koncerti.

63



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Dëgjim i drejtuar

Nxënësit ndahen në grupe.

Në secilin grup mësuesi/ja shpërndan ushtrimin e përgatitur.

Aktiviteti 1: Detyrë e nxënësve është që të dallojnë kompozitorin nga dirigjenti, interpretuesi dhe anasjelltas.

Aktiviteti 2: Detyrë e nxënësve është që në kolonën e dytë të gjejnë përgjigjet e pyetjeve që ndodhen në kolonën e parë.

Çfarë bën kompozitori?

Çfarë bën dirigjenti?

Çfarë bën interpretuesi?

Aktiviteti 3: Dëgjojnë me vëmendje nga CD-ja dhe bëjnë dallimin në mes instrumenteve që dëgjojnë. Demonstronjë dhe përshkruajnë se në ç'mënyrë këta interpretues luajnë në instrumentet e tyre.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënët

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit imitojnë dirigjentin në bazë të muzikës së dëgjuar. Përshkruajnë emocionet që kanë përjetuar gjatë një koncerti. Puna e tyre monitorohet, ndihmohet dhe prezantohet.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, mënyrën e imitimit të dirigjentit.

Detyrë:

Shkruajnë për biografinë e ndonjë dirigjenti ose kompozitori.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë muzikore
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Krijimet muzikore

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Këndon ose luan në instrumente fëmijërore ndonjë krijim origjinal të shkurtër.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.5; III.4,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kompozitorët e vegjël

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Punon të gjitha llojet e figurave gjeometrike T, K, D, Rr.
- Radhit figurat gjeometrike sipas shembullit të dhënë.
- Aplikon melodi sipas figurave gjeometrike.
- Krijon ritmin e tyre me figura gjeometrike.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, etiketa me figura gjeometrike, laptopi, projektori.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja parashtron disa pyetje për të nxitur diskutimin.

Çfarë kuptoni me fjalën kompozitor?

Çfarë krijon një kompozitor?

Mendimet e nxënësve diskutohen me klasën.



Detyra

Kompozitorët e vegjël



Duartrokit



Godit me gjunjë




Trokit me gishtërinj




Godit me këmbë në dysHEME



Të krijojmë muzikë së bashku!



Krijo ritmin tënd!



65




Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Dëgjim i drejtuar

Nxënësit ndahen në grupe.

Aktiviteti 1: Nxënësit në grupe krijojnë figura gjeometrike. Secili grup duhet të ketë para vetes trekëndësha, katrorë, rathë dhe drejtkëndësha.

Aktiviteti 2: Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që figurat e krijuara t'i radhisin sipas shembullit të dhënë.



Aktiviteti 3: Nxënësit zëvendësojnë figurat sipas shembullit të dhënë:

Duartrokasin



Godit me gjunjë



Trokit me gishtërinj

Godit me këmbë në dysheme

Aktiviteti 4: Krijojnë muzikë së bashku



Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit në grupe krijojnë ritmin e tyre. Mësuesi/ja i monitoron dhe i ndihmon ata që kanë nevojë. Pas përfundimit, secili grup prezanton ritmin e krijuar.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, mënyrën e interpretimit të ritmit të krijuar.

Detyrë:

Të krijojnë ritmin e tyre.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Këngët

Rezultatet e të nxënit të temës:

Këndon dhe interpreton në instrumente.
Shoqëron këndimin me zë, me duar.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.5; III.4; III.9; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: “Xixëllonja”

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Këndon këngën duke zbatuar rregullat e këndimit.
- Shoqëron këngën me duar duke kënduar grupi.
- Përshkruan xixëllonjën duke plotësuar skemën sipas udhëzimeve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletët A4, CD-ja, printeri, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja lexon një gjëgjëzë para nxënësve.

Detyrë e nxënësve është që në dyshe të gjejnë përgjigjen e gjëgjëzës. (Hap e mbyll, ndrit si yll.)

Mendimet e nxënësve diskutohen me klasën.

Dyshja më e shpejtë dhe më e saktë shpallet fituese.

“Xixëllonja” CD 40

Muzika: Gazmend Zajmi
Teksti: Gazmend Zajmi

Ç'është ky yll i vo - gël nga qie - lli që ka rr'shqit Ç'është kjo xix' me
fla - tra në-për terr që ndrit Xi - xë xi - xë llo - nja në - për qiell flut'
ron__ por - si diell - i vo - gël rru - gën na ndri - çon

Porsi flak' e vogël
Nga qielli që është' hedh'
Një flurom' e vogël
Rreth e rrotull bredh!

Ref. Xi-xi xixëllonjë
Moj flurom' e ndritur
Ballin tim me ty, oh
Kam për ta stolisur.

66





“Xixëllonja”

CD 40

Muzika: Gazmend Zajmi
Teksti: Gazmend Zajmi



 Ç'është ky yll i vo - gël nga qie - lli që ka rrshqit Ç'është kjo xix' me

 fla - tra në-për terr që ndrit Xi - xë xi - xë llo - nja në - për qiell flut

 ron - por - si diell - i vo - gël rru - gën na ndri - çon

Porsi flak' e vogël
Nga qielli që është hedh'
Një flurom' e vogël
Rreth e rrotull bredh!

Ref. Xi-xi xixëllonjë
Moj flurom' e ndritur
Ballin tim me ty, oh
Kam për ta stolisur.



66



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive: Përpunimi i përmbajtjes Dëgjim i drejtuar

Aktiviteti 1: Nxënësit njoftohen me këngën që do ta mësojnë. Titulli “Xixëllonja” paraqitet përmes projektorit (titulli shkruhet në tabelë në mungesë të projektorit).

Pastaj kënga e ndarë në strofa paraqitet në tabelë. Mësohet kënga strofë për strofë.

Aktiviteti 2: Lëshohet kënga në CD dhe dëgjohet me vëmendje interpretimi i këngës.

Aktiviteti 3: Njoftohen nxënësit se kënga këndohet sipas rregullave: Një nxënës këndon këngën, kurse nxënësit e tjerë e shoqërojnë me duar.

Nxënësit individualisht dhe në grup këndojnë këngën e mësuar, duke e shoqëruar me zë dhe me duar.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënët

Në këtë pjesë të orës mësimore, i shpërndahet secilit nxënës nga një ushtrim i përgatitur nga

Xixëllonja

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, mënyrën e interpretimit të këngës.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin këngën me notat muzikore.

Reflektim për vjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Krijimet muzikore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Ritmizon në mënyrë kreative vargjet, poezitë, gjëgjëzat etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.4; III.4; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Gjëgjëza

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Zbulon së paku emrin e një gjëgjëze.
- Vizaton katrorët e mëdhenj dhe të vegjël sipas ritmit të rrokjeve.
- Shoqëron rrokjet me shtagëza apo duartrokitje.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, shtagëza, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja parashtron disa pyetje për të nxitur diskutimin.

Çfarë janë gjëgjëzat?

Kush i ka krijuar?

A dini ndonjë gjëgjëzë?

Mendimet e nxënësve diskutohen me klasën.



Detyra

Gjëgjëza

Vizato rrokje të gjata me katrorët e mëdhenj dhe rrokje të shkurtra me katrorët e vegjël.

1

Një shtë - pi ka - tër rro - ta

Me dri - ta - re me dy rro - ta

Në - për rrug shkon e vjen

Është ç'është kush e gjen?

2

Tym tym ko ko tym as an - dej as kën - dej po për - pjet' si shigjet'

I gjetët gjëgjëzat?

Pasi ta keni përvetësuar mirë dhe pa gabime, provoni që rrokjet t'i shoqëroni me shtagëza ose duartrokitje.



Detyra

Gjëgjëza

Vizato rrokje të gjata me katrorët e mëdhenj dhe rrokje të shkurtra me katrorët e vegjël.

1

Një shtë - pi ka - tër rro - ta

Me dri - ta - re me dy rro - ta

Në - për rrug' shkon e vjen

Është ç'është kush e gjen?

2

Tym tym ko ko tym as an - dej as kën - dej po për - pjet' si shigjet'

I gjetët gjëgjëzat?

Pasi ta keni përvetësuar mirë dhe pa gabime, provoni që rrokjet t'i shoqëroni me shtagëza ose duartrokitje.

67



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Dëgjim i drejtuar

Aktiviteti 1: Nxënësit ndahen në dyshe. Në secilën dyshe, mësuesi/ja shpërndan gjëgjëzat e përgatitura nga vetë ai/ajo. Detyrë e nxënësve është që të gjejnë se për kë bëhet fjalë. Grupi që zbulon gjëgjëzat shpallet fitues.

Aktiviteti 2: Vizatojnë rrokje të gjata me katrorët e mëdhenj dhe rrokje të shkurtra me katrorët e vegjël.

Aktiviteti 3: Përvetësojnë mirë dhe pa gabime dy gjëgjëzat e paraqitura në libër.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit

Në këtë pjesë të orës mësimore, pasi ta kenë përvetësuar mirë dhe pa gabime, provojnë që rrokjet t'i shoqërojnë me shtagëza ose duartrokitje.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, mënyrën e interpretimit të gjëgjëzave dhe gjetjen e tyre.

Detyrë:

Shkruajnë nga dy gjëgjëza secili prej tyre.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Instrumentet muzikore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Krijon instrumente muzikore ritmike me materiale ricikluese dhe organike.

Dallon instrumentet për nga materiali ndërtues, burimi tingullor, mënyra e interpretimit, ansambleve që u përkasin etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,8 ;II.5; III.4;V,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.8; 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Të ndërtojmë instrumente

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Krijon instrumentin e pëlqyer nga materiale ricikluese.
- Përshkruan thjesht me disa fjali përbërjen dhe tingullin që lëshon.
- Arsyeton së paku me një fjali përzgjedhjen e punimit më të mirë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: materiale ricikluese, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim i njohurive para-prake


Mësuesi/ja fillimisht shfaq për disa minuta në videoprojektor videon me hapat e krijimit të disa prej instrumenteve muzikore (<https://www.youtube.com/watch?v=yrCEqdMfbno>). Nga nxënësit kërkohet që t'i vështrojnë me kujdes videot e paraqitura, duke ndjekur hapat e krijimit të instrumenteve.

Të ndërtojmë instrumente

1

Lodra e vogël

Gotat e mëdha të letrës apo kanaçet mbulohen me një pjesë të balonës, të cilën e lidhim me pe të fortë apo me llastik për mbylljen e kavanozave që përdoren në shtëpi. Për të prodhuar tingullin, atë e godasim me gishta apo lapsa. Mos harro: madhësia e gotave e ndryshon edhe lartësinë e tingujve!



2

Marakasi

Mjetet e nevojshme:

2 lugë druri apo plastike dhe një nga lodrat apo nga dhuratat që kenë në shtëpi.

Marrim dy lugë të plastikës. Gjysmën e lodrës e mbushim me oriz ose fasule dhe i bashkojmë. Të bashkuara, i shtojmë lugët nga anash, të cilat i mbështjellim me ngjites, si në fotografi. Tani jemi gati për t'i shoqëruar këngët dhe ushtrimet tona më të pëlqyera.





Marakasin mund ta punojmë edhe në këtë mënyrë:


Mjetet e nevojshme:
Dy gota plastike, shirit ngjitës dhe fasule apo oriz.

Gjysmën e njëres gotë e mbushim me oriz apo fasule. Duke treguar kujdes, ngjisim dy gotat me shirit ngjitës. Me këtë instrument mund t'i luani të gjitha këngët e mësuara.



3 Kastanjeta

Për të krijuar një kastanjëtë, marrim një pjesë kartuçi dhe e ndajmë në mes. Në pjesët e skajshme ngjisim kapakët, te të cilët paraprakisht kemi përdorur ngjitës. Luajtja në to bëhet duke i bashkuar kapakët dhe duke krijuar tingull!



4 Lugët

Lugët mund të na shërbejnë edhe në muzikë. Duke i goditur njërën me tjetrën, luajmë së bashku dhe i shoqërojmë ushtrimet apo këngët e mësuara.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Mendo - puno - thuaja grupit

Në këtë veprimtari kërkohet nga nxënësit që të hapin tekstin shkollor. Nxënësit mësojnë për lodrën e vogël, marakastin dhe kastanjëtën.

Ndahen nxënësit në grupe.

Grupi i parë ka për detyrë që me mjetet ricikluese, që kanë sjellë nga shtëpitë e tyre, të ndërtojnë lodrën e vogël.

Grupi i dytë ka për detyrë që me mjetet ricikluese, që kanë sjellë nga shtëpitë e tyre, të ndërtojnë marakastin.

Grupi i tretë ka për detyrë që me mjetet ricikluese, që kanë sjellë nga shtëpitë e tyre, të ndërtojnë kastanjëtën.

Nxënësit tregojnë përbërjen e instrumentit të krijuar dhe tingujt që lëshojnë instrumentet.



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit vendosin krijimet mbi bankë dhe bëhet "turi i galerisë". Nxënësit vëzhgojnë dhe japin pëlqimin e tyre për krijimin më të bukur. Puna e tyre monitorohet dhe ndihmohet.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për punimin e instrumenteve muzikore me saktësi, mënyrën e prezantimit të punës së përfunduar.

Detyrë:

Të punojnë ndonjë instrument muzikor me mjete ricikluese.

Reflektim për vajdhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Këngët

Rezultatet e të nxënit të temës:

Këndon dhe interpreton në instrumente.

Shoqëron këndimin me zë, me duar.

Kontributi në rezultatet për kompetencat

kryesore të shkallës: I.3; II.5; III.4; III.9; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulës: 1.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: “Ëndrra dhe dëshira”

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Këndon këngën duke zbatuar rregullat e këndimit.
- Shoqëron këngën me duar ose me ndonjë vegël muzikore duke kënduar grupi.
- Shpjegon me gjuhë të thjeshtë ëndrrën ose dëshirën që ka paraqitur përmes ilustrimit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD-ja, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja parashtron disa pyetje për të nxitur diskutimin.

Cilat janë ëndrrat e tua?

Cilat janë dëshirat e tua?

Ku qëndrojnë dallimet në mes të ëndrrave dhe dëshirave?

Mendimet e nxënësve diskutohen me klasën.

“Ëndrra dhe dëshira” CD 41

Muzika: Dritan Lumshi
Teksti: Leidi Shqiponja

Intro.
Be-sa_moj, ça-ma-rro-ke shum' dë-shi-ra ke.

Intro.
Larg e_lart shkon me to, pas na_merr dhe ne.

Solisti Kori Solisti
Kot' më tho-ni. Po pse?! Ën-dë-rrój si çdo fë-mij.

Kori Solisti Kori
Kot dy-sho-ni. Po pse?! Ënd-rrat, jo nuk kan'ku-fij, Ja, ta-ni ti po bën vrap.

Solisti Kori
Du-a Die-llin që ta kap, kal-tër si ve ta tër-heq. Vra-po Be-sa, ka - pe shpejt!

1. Trego për ëndrrat e tua.
2. Po dëshirat?

70



71



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Dëgjim i drejtuar

Aktiviteti 1: Nxënësit njoftohen me këngën që do ta mësojnë. Titulli “**Ëndrra dhe dëshira**” paraqitet përmes projektorit (titulli shkruhet në tabelë në mungesë të projektorit).

Pastaj kënga e ndarë në strofa paraqitet në tabelë. Mësohet kënga strofë për strofë.

Aktiviteti 2: Lëshohet kënga në CD dhe dëgjohet me vëmendje interpretimi i këngës.

Aktiviteti 3: Njoftohen nxënësit se kënga këndohet sipas rregullave: Një nxënës këndon këngën, kurse nxënësit e tjerë e shoqërojnë me duar. Nxënësit individualisht dhe në grup këndojnë këngën e mësuar, duke e shoqëruar me zë dhe me duar.



Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Vizatim

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit vizatojnë ëndrrën ose dëshirën e tyre. Puna e tyre monitorohet dhe ndihmohet. Pas mbarimit

të punës, krijimet ekspozohen në grupe. Secili bën shpjegimin e krijimit të tij, duke folur me gjuhë të thjeshtë artistike.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, mënyrën e interpretimit të këngës dhe vizualizimin e ëndrrave dhe dëshirave të tyre.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin këngën me notat muzikore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Kënga

Rezultatet e të nxënit të temës:

Këndon dhe interpreton në instrumente.
Shoqëron këndimin me zë, me duar.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.5; III.4; III.9; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: “Pesa në librezë”

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Këndon këngën duke zbatuar rregullat e këndimit.
- Shoqëron këngën me duar duke kënduar grupi.
- Paraqet në pentagram notat e këngës sipas udhëzimit të dhënë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD-ja, printeri, laptopi, pentagrami.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim i njohurive paraprake

Mësuesi/ja fillimisht paraqet përmes projektorit skemën e mëposhtme. Brenda rrethit shkruan “Libreza”. Mendimet e nxënësve shkruhen në secilin drejtkëndësh. Varësisht prej kohës, disa prej tyre lexohen.



“Pesa në librezë”

Muzika: Reshat Randobrava
Teksti: Zejnullah Halili

Hasteshtës

Er - dhi çu - pa, er - dhi sot erdh nga shko - lla g'zi - me plot!
Er - dhi fun - di er - dhi pra fun - di vi - tit ton' shko - llor,

I del pa - ra nën' e saj dhe e për - qa - foj Qesh bashk me
ne nga m'su - sja sot jem... ndarë t'gjith'jem shem - bu - llore

sho - aet g'zi - mi der - dhet n'fush' ne sot li - bre - zat pe - sa i kem mbush'.

Edhe ky vit mbaroi!

Ju presin deti, mali, udhëtimet, aventurat librat dhe këngët e reja!





“Pesa në librezë”

Hatëshëm

Muzika: Reshat Randobrava
Teksti: Zejnallah Hatili



Edhe ky vit mbaroi!

Ju presin deti, mali, udhëtimet, aventurat librat dhe këngët e reja!



72



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Dëgjim i drejtuar

Aktiviteti 1: Nxënësit njoftohen me këngën që do ta mësojnë. Titulli “Pesa në librezë” paraqitet përmes projektorit (titulli shkruhet në tabelë në mungesë të projektorit).

Pastaj kënga e ndarë në strofa paraqitet në tabelë. Mësohet kënga strofë për strofë.

Aktiviteti 2: Lëshohet kënga në CD dhe dëgjohet me vëmendje interpretimi i këngës.

Aktiviteti 3: Njoftohen nxënësit se kënga këndohet sipas rregullave: Një nxënës këndon këngën, kurse nxënësit e tjerë e shoqërojnë me duar. Nxënësit individualisht dhe në grup këndojnë këngën e mësuar, duke e shoqëruar me zë dhe me duar.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit kanë për detyrë që të paraqesin në pentagram këngën me notat muzikore.

Puna e tyre monitorohet dhe ndihmohet.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, mënyrën e interpretimit të këngës.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin këngën me notat muzikore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë muzikore
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Veprat artistike

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjatë bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje, mimikë, me mjete shprehëse të tjera artistike etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: : I.3,4; III.4; VI.2,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përmbledhje e punës

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shkruan se cilin instrument ka përdorur për ta përcjellë këngën e pëlqyer.
- Arsyeton me një fjali pse i pëlqen ky instrument.
- Përmbledh me tri fjali emocionet e tij/saj gjatë dëgjimit të veprës së pëlqyer.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
 Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë, Edukatë figurative; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja parashtron disa pyetje për të nxitur diskutimin.

*Cila ishte kënga juaj më e pëlqyer e vitit?
 Trego pse.*

Nxënësit në mënyrë individuale shprehin mendimet e tyre. Puna e tyre prezantohet.

Përmbledhje e punës



Shëno:
 Cila është kënga më e pëlqyer e vitit?
 Trego pse.

Blank lines for writing the answer to the first question.



Cili është instrumenti yt më i pëlqyer, me të cilin ti ke shoqëruar ndonjë këngë?
 Trego edhe cilën këngë e ke shoqëruar më së miri me instrumente ritmike.

Blank lines for writing the answer to the second question.



Shkruaj përshtypjet e tua për veprën më të pëlqyer që ti ke dëgjuar.

Blank lines for writing the answer to the third question.

Përmbledhje e punës



Shëno:

Cila është kënga më e pëlqyer e vitit?
Trego pse.



Cili është instrumenti yt më i pëlqyer, me të cilin ti ke shoqëruar ndonjë këngë?
Trego edhe cilën këngë e ke shoqëruar më së miri me instrumente ritmike.



Shkruaj përshtypjet e tua për veprën më të pëlqyer që ti ke dëgjuar.

73



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Mendo - puno - thuaja grupit

Në këtë pjesë të orës mësimore bëhet përmbledhje e punës së bërë.

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur, duke ndjekur aktivitetet e paraqitura.

Aktiviteti 1: Nxënësit tregojnë se cili ka qenë instrumenti i tyre më i pëlqyer, me të cilin kanë shoqëruar ndonjë këngë.

Aktiviteti 2: Tregojnë cilën këngë e kanë shoqëruar më së miri me instrumente ritmike.

Pastaj punën e tyre e ndajnë me grupin e madh të klasës.



Përforsimi:

Konsolidimi i të nxënit

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit shkruajnë përshtypjet e tyre për veprën më të pëlqyer që kanë dëgjuar.

Mësuesi/ja e monitoron punën e tyre, dhe i ndihmon ata që kanë nevojë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për mënyrën e prezantimit të punës së tyre.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin këngën e tyre më të pëlqyer.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

